



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 262 Akti

Nr. 260 Vendimi
Tiranë, më 15.6.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në datën 5.6.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Petrit Aliaj**, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Z. Petrit Aliaj është subjekt rivlerësimi, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Z. Petrit Aliaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit si subjekt rivlerësimi, duke u shortuar me shortin e datës 15.1.2019, në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga ku rezultoi trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Në datën 7.2.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, anëtarja e trupit gjykues, komisionerja Pamela Qirko, paraqiti kërkesën për dorëheqje nga subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Aliaj.

4. Kjo kërkesë u shqyrtua nga një trup tjetër gjykues, i ngritur me short, i cili, me vendimin e datës 12.2.2019 vendosi pranimin e kërkesës për dorëheqje të anëtares Pamela Qirko nga shqyrtimi i çështjes. Anëtari zëvendësues i caktuar me short, rezultoi komisionere Brunilda Bekteshi.

5. Menjëherë me zëvendësimin e anëtares së trupit gjykues u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31- 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe; Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

6. Trupi gjykues, pasi caktoi me mirëkuptim kryesuese komisioneren znj. Etleda Çiftja, si dhe pasi nga anëtarët e trupit gjykues u deklarua mospasja e konfliktit të interesit, vendosi fillimin e hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

7. Me vendimin nr. 2, datë 20.2.2020, trupi gjykues, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Aliaj, mbështetur vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi provat për këtë kriter arritën nivelin e provueshmërisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, për kriterin e pasurisë, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, për kriterin e pasurisë, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për marrjen e provave ose thirrjen e dëshmitareve dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

8. Në vijim, nëpërmjet postës elektronike¹ të datës 20.2.2020, subjekti u njoftua për sa më sipër.

9. Subjekti i rivlerësimit, në datën 28.2.2020², kërkoi shtyrjen e afatit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit, pasi e kishte pasur të pamundur hapjen e e-mail-it pasi nga pakujdesia nuk kishte kontrolluar adresën elektronike.

10. Trupi gjykues pavarësisht se kërkesa nuk ishte e bazuar ligjërisht, vlerësoi për t’i dhënë kohë shtesë subjektit për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave deri në datën e zhvillimit të seancës dëgjimore, duke e njoftuar se ajo do të mbahej në datën 5.3.2020, ora 10:30.

11. Në datën 2.3.2020 subjekti i rivlerësimit paraqiti para Komisionit në formë elektronike shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, disa prova dhe kërkesën për shtyrje afati..

12. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet, provat, analizoi kërkesën e paraqitur nga subjekti, në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe aktit të brendshëm rregullativ të Komisionit “Hapat proceduralë të unifikuar” miratuar me vendimin nr. 7, datë 12.2.2018 të Komisionit, i ndryshuar.

12.1 Me vendimin e datës 3.3.2020, trupi gjykues, vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit për shtyrje të mëtejshme të afatit kohor për të paraqitur prova me arsyetimin se i kishte bërë me dije subjektit gjatë hetimit administrativ³ kërkesën për plotësimin e të njëjtave kërkesa, duke i dhënë

¹ E-mail, datë 20.2.2020, dërguar subjektit me lëndën: “njoftim për përfundimin e hetimit administrativ”.

² Nëpërmjet postës elektronike të datës 28.2.2020.

³ Lidhur me kërkimin e parë: Komisioni vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit për shtyrje të mëtejshme të afatit kohor për marrjen e një informacioni të dokumentuar për aktivitetin privat të shtetasit P.K në shtetin grek”, për sa i ka kërkuar në vijimësi subjektit që në 18.7.2019 kërkime për sa më sipër, dhe në datën 9.9.2019 i ka ridërguar komunikimin, pasi ka konstatuar mospërgjigjen nga ana e tij, duke i lënë 10 ditë kohe, në vijim të të cilit subjekti ka kërkuar kohë shtesë e Komisioni ka njoftuar se ka shtyrë afatin deri në datën 30.9.2019. Nga kjo periudhë subjekti ka qenë në dijeni të detyrimit të provimit të sa më sipër.

kohën e mjaftueshme për paraqitjen e tyre, dhe njohu subjektin me këtë vendim nëpërmjet komunikimit, në postën elektronike të datës 3.3.2020.

13. Në datën 4.3.2020, subjekti i rivlerësimit:

(i) depozitoi në protokollin e Komisionit aktet të cilat ishin paraqitur edhe nëpërmjet komunikimit, me postën elektronike të datës 2.3.2020.

(ii) depozitoi kërkesën⁴ për kohë shtesë për paraqitjen e dokumenteve⁵, në analizë të të cilës, trupi gjykues konstatoi se në të ishin parashtruar kërkesa të cilave u ishte dhënë përgjigje nga trupi gjykues, me vendimin e ndërmjetëm të datës 3.3.2020, i cili i ishte bërë i njohur subjektit, me përjashtim të kërkesës më poshtë e cila ishte kërkesë e re.

Komisioni vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit, për shtyrje të mëtejshme të afatit kohor për të paraqitur deklarata në formën e kërkuar nga ligji nga personat, tek të cilët kishte qëndruar jashtë shtetit, në Greqi, për të provuar shpenzimet e akomodimit; (e vetmja kërkesë e re për të cilën trupi gjykues nuk kishte disponuar në datën 3.3.2020), për sa i ka kërkuar në vijimësi subjektit që në **18.7.2019** për sa më sipër, ridërguar komunikimi në datë 9.9.2019 në vijim shtyrë afati deri në datën 30.9.2019. Nga kjo periudhë subjekti ka qenë në dijeni të detyrimit të provimit të sa më sipër.

(iii) depozitoi raportin për paaftësi të përkohshme në punë me nr. *** regj., lëshuar nga Spitali Rajonal Vlorë, me diagnozën “gjendje febrile”: pushim tre ditë, prej datës 4.3.2020 – 6.3.2020⁶, duke kërkuar shtyrje të seancës së datës 5.3.2020, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore.

14. Trupi gjykues vendosi dhe njoftoi subjektin se është njohur me pamundësinë e tij për t’u paraqitur ne seancën dëgjimore të datës 5.3.2020, për arsye shëndetësore sipas raportit për paaftësi të përkohshme, depozituar elektronikisht dhe në protokollin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore të planifikuar nga data **5.3.2020/ora 10.30** në datën **9.3.2020/ora 14.15** në të njëjtën sallë të Pallatit të Koncerteve, duke e njoftuar subjektin nëpërmjet postës elektronike të datës 4.3.2020.

15. Në datën 9.3.2020 subjekti paraqiti nëpërmjet protokollit zyrtar të Komisionit si vijon:

(i) kërkesë, bazuar në nenin 137 dhe 140 të K.Pr.Administrative, për revokimin e vendimit të ndërmjetëm të datës 3.3.2020 të trupit gjykues, duke referuar se ky vendim kishte rrëzuar kërkesën e tij për marrjen e provave të reja.

(ii) kërkesë për riçelje të hetimit administrativ edhe për dy kritere të tjera, të figurës dhe aftësitë profesionale,

Lidhur me kërkimin e dytë: Komisioni vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit për shtyrje të mëtejshme të afatit kohor për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe të dokumentuar të ardhurat e ligjshme të fituara nga vajza R.A në SHBA gjatë gjithë periudhës së qëndrimit të saj, për sa i ka kërkuar në vijimësi subjektit që në **18.7.2019** kërtime për sa më sipër, dhe në datën 9.9.2019 i ka ridërguar komunikimin, pasi ka konstatuar mospërgjigjen nga ana e tij, duke i lënë 10 ditë kohë, në vijim të të cilit subjekti ka kërkuar kohë shtese e Komisioni ka njoftuar se ka shtyrë afatin deri në datën 30.9.2019. Nga kjo periudhë subjekti ka qenë në dijeni të detyrimit të provimit të sa më sipër.

Lidhur me kërkimin e tretë: Komisioni vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit për shtyrje të mëtejshme të afatit kohor për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe të dokumentuar për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe të dokumentuar përkatës, për shtetasin S për sa i ka kërkuar në vijimësi subjektit që ne **18.7.2019** kërtime për sa më sipër dhe në datën 9.9.2019 i ka ridërguar komunikimin, pasi ka konstatuar mospërgjigjen nga ana e tij, duke i lënë 10 ditë kohë, në vijim të të cilit subjekti ka kërkuar kohë shtese e Komisioni ka njoftuar se ka shtyrë afatin deri në datën 30.9.2019. Nga kjo periudhë subjekti ka qenë në dijeni të detyrimit të provimit të sa më sipër.

⁴ Protokolluar me nr. **** prot., datë 4.3.2020: kërkesë për kohë për marrjen e deklaratave në formën e kërkuar nga ligji nga personat tek të cilët kanë qëndruar jashtë shtetit, në Greqi, për të provuar shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit të mbuluar prej tyre; për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe dokumentuar të ardhurat e ligjshme të fituara nga vajza R.A në SHBA gjatë gjithë periudhës së qëndrimit të saj; për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe të dokumentuar përkatës, për hyrje-daljet në territorin e Shqipërisë të shtetasit S. A, drejtuar me shkresë zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin, Policia Kufitare Rinas. Nga kjo periudhë subjekti ka qenë në dijeni të detyrimit të provimit të sa më sipër.

⁵ Me përmbajtje deklarimi i lidhur me shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të familjareve në SHBA nga viti 2009-2018.

⁶ I aftë për punë, datë 7.3.2020.

(iii) depozitoi raportin për paaftësi të përkohshme datë 7.3.2020, me nr. regjistri *****, lëshuar nga spitali “C”, me diagnozën “lumbago akute”, nga data 7.3.2020 – 9.3.2020⁷, duke kërkuar shtyrje të seancës së datës 9.3.2020, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore.

16. Trupi gjykues me marrjen dijeni, njoftoi subjektin me *e-mail* se është njohur me pamundësinë e tij për t’u paraqitur ne seancën dëgjimore e datës 9.3.2020, për arsye shëndetësore sipas raportit për paaftësi të përkohshme, depozituar në protokollin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore të planifikuar në datën **11.03.2020** në të njëjtën sallë të Pallatit të Koncerteve,

17. Trupi gjykues, njoftoi subjektin duke i kërkuar që, nëse nuk mund të paraqitej në seancën vijuese dëgjimore për arsye shëndetësore, të merrte masat e duhura ligjore për delegimin e një përfaqësuesi ligjor për përfaqësimin dhe paraqitjen e shpjegimeve të tij në seancën e radhës.

18. Trupi gjykues, në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe aktit të brendshëm rregullativ të Komisionit “Hapat proceduralë të unifikuar” miratuar me vendimin nr. 7, datë 12.2.2018 të Komisionit, i ndryshuar, i publikuar në faqen zyrtare të Komisionit, mori në shqyrtim kërkesat e subjektit të datës 9.3.2020 dhe me vendimin e ndërmjetëm të datës 10.3.2020 vendosi si vijon:

18.1 Lidhur me kërkimin e parë mbi revokimin e vendimit të ndërmjetëm të datës 3.3.2020, referuar bazës ligjore, të kërimit të subjektit, ky kërkim është i pabazuar, për arsye se Komisioni nuk e ka tagrin të disponojë mbi ankimet e subjekteve kundër vendimeve të ndërmjetme, dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të cilat ankimohen në përputhje me nenin 63 të ligjit nr. 84/2016 në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

a) Në materie të pretendimit të subjektit se Komisioni ka rrëzuar kërkesën për marrjen e provave të tjera, duke i privuar në këtë mënyrë atij një nga të drejtat kryesore, atë të barrës së provës, trupi gjykues njoftoi subjektin se kjo kërkesë e pretendim i tij ishte i pabazuar, dhe jo i saktë.

b) Vendimi i ndërmjetëm i trupit gjykues datë 3.3.2020, nuk ka disponuar mbi rrëzimin e kërkesës për marrjen e provave të tjera, por për refuzimin e kërkesës për shtyrje afati për të paraqitur prova, për arsye se trupi gjykues i ka shtyrë afatin disa herë subjektit për t’i dhënë mundësi për të siguruar provat. Komisioni gjithashtu njoftoi subjektin se nuk i ka privuar të drejtën për të paraqitur prova, e se provat ai mund t’i paraqiste deri në përfundim të seancës dëgjimore.

18.2 Lidhur me kërkimin e dytë për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e rivlerësimit: trupi gjykues vlerësoi se provat për kriterin e pasurisë kanë arritur nivelin e provueshmërisë në kuptim të nenit 4 pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe për rrjedhojë, kërkesa për riçelje të hetimit edhe për dy kriteret e tjera, nuk duhej pranuar.

19. Në datën 10.3.2020, pas administrimit të raportit nëpërmjet postës elektronike dhe marrjes së vendimit të ndërmjetëm, trupi gjykues i bëri me dije subjektit vendimin e ndërmjetëm si dhe e rinjoftoi subjektin se *sikundër ishte njoftuar, trupi gjykues i kishte kërkuar të merrte masa për përfaqësimin e tij nga një përfaqësues ligjor, ndaj në këto kushte seanca do të vijonte sipas planizimit ditën e nesërme, datë 11.03.2020 në orën 11.00 në Pallatin e Koncerteve.*

19.1 Këtij komunikimi, subjekti iu përgjigj: “Për sa i përket kërkesës tuaj për delegimin e një përfaqësuesi ligjor për përfaqësimin në seancën dëgjimore, nuk mundem të marr përfaqësues të paraqitet në seancë, pasi e shoh të domosdoshme paraqitjen time personalisht në seancën dëgjimore si një e drejtë kushtetuese dhe ligjore, referuar nenit 6 pika b) dhe c) të Konventës së parë Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 93 të Kodit të Procedurës Civile, nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.” Në këtë komunikim ai paraqiti nëpërmjet postës

⁷ I aftë për punë, datë 10.3.2020.

elektronike, edhe raportin mjekësor, lëshuar datë 10.03.2020 nga Spitali “C”, në të cilin citohej se pacienti ishte shtruar me datë 10. 3.2020 me Dg: “Hernie diskale hiperalgjike e spondiloartrozë”.

19.2 Trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit se nuk mund të merrte përfaqësues në seancë, pasi e shihte të domosdoshme paraqitjen personalisht në seancën dëgjimore, si një e drejtë kushtetuese dhe ligjore, ishte në keqinterpretim të dispozitave ligjore, mbrojtja e subjektit nga përfaqësuesi ligjor ishte garanci për pjesëmarrje në proces, referuar Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e nuk cënon procesin e rregullt ligjor.

19.3 Në referim të veprimeve të përsëritura të subjektit, trupi gjykues vendosi të shtyjë pa afat seancën dëgjimore të datës 11.3.2020 me qëllim që të hetonte procedurat ligjore të ndjekura për lëshimin e raporteve mjeko-ligjore nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe me qëllim të kërkimit të informacionit nga Këshillit i Lartë Gjyqësor, mbi prezencën në punë të subjektit gjatë kohëzgjatjes së raporteve mjeko-ligjore.

20. Me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2020, KLGj informoi Komisionin si më poshtë vijon:

*“ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2020, kemi kërkuar nga Gjykata e Apelit Vlorë informacion nëse gjyqtari Petrit Aliaj është paraqitur në punë nga data 11.3.2020 deri në momentin e paraqitjes së shkresës dhe si ka qenë vijueshmëria e frekuentimit nga ana e tij.*

*Me shkresën nr. *** prot., datë 29.4.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë, protokolluar në KLGJ me nr. **** prot., datë 4.5.2020, jemi vënë në dijeni se ky subjekt nuk ka paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën 11.3.2020 dhe deri në momentin e përgjigjes. Gjithashtu, jemi vënë në dijeni se gjyqtari Petrit Aliaj është paraqitur në punë në mënyrë të pandërprerë gjatë kësaj periudhe dhe ka marrë pjesë në të gjitha gjykimet, ku ka qenë relator apo anëtar i trupit gjykues.”*

21. Sipas informacionit të mësipërm, rezultonte se subjekti i rivlerësimit në datën 11.3.2020, që ishte planifikuar zhvillimi i seancës dëgjimore, një ditë pas shtrimit në spitalin “C”, Tiranë, fakt për të cilin subjekti kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 11.3.2020, ishte paraqitur në vendin e tij të punës, në Gjykatën e Apelit Vlorë.

22. Trupi gjykues, në konsideratë të sa rezultoi në lidhje me mosparaqitjen e subjektit në seancë dëgjimore të datës 11.3.2020, për arsye të shtrimit të tij në spitalin “C” Tiranë, si dhe paraqitjes së tij në datën e planizuar për seancë në vendin e tij të punës, në Gjykatën e Apelit Vlorë, vlerësoi se subjekti ishte përpjekur të shtyjë seancën dhe të ndikojë në vonesën e procesit të rivlerësimit.

23. Në datën 2.6.2020, nëpërmjet komunikimit, në postën elektronike, subjekti ri-paraqiti kërkesë për riçelje hetimi për kriterin e pasurisë edhe për dy kriteret e tjera të vlerësimit, kontrollit të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe kërkoi kohë për të paraqitur dokumentacionin që lidhet me punësimin e djalit L. A, në Greqi.

24. Pas administrimit të kërkesave, trupi gjykues njoftoi subjektin se

- për sa i përket kërkesës së tij për riçelje hetimi, pas seancës dëgjimore dhe para marrjes së vendimit përfundimtar trupi gjykues do të vlerësonte të gjitha provat dhe shpjegimet e dhëna para dhe gjatë seancës dhe, nëse ato do të vlerësoheshin se janë bindëse dhe të mjaftueshme për rihapjen e hetimit, atëherë trupi gjykues do të procedonte me marrjen e vendimit për rihapjen e hetimit

- për sa i përket kërkesës së tij, për dhënie kohë shtesë për paraqitjen e dokumentacionit për punësimin e djalit L.A, në Greqi, trupi gjykues e njoftoi njoftoi subjektin mbi mospranimin e kesaj kerkese, bazuar në nenin 49/6/a të ligjit nr. 84/2016.

25. Në ditën e seancës gjyqësore, datë 5.6.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti raport për paaftësi të përkohshme në punë, me nr. *** regj., datë 5.6.2020, lëshuar nga Poliklinika e Specialiteteve

S.R.V, me diagnozën “lumbago”, që fillonte prej datës 5.6.2020⁸, duke arsyetuar se nuk mund të paraqitet në seancën dëgjimore për këtë arsye shëndetësore.

26. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë se subjektit nëpërmjet komunikimit elektronik⁹ në mënyrë të përsëritur i ishte bërë me dije se nëse do të vijonte pamundësia e paraqitjes së tij personalisht në seancë për shkaqe shëndetësore, ai duhet të merrte masa për caktimin e një përfaqësuesi ligjor në seancë, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin e bërë të ditur nga KLGJ, se ditën e seancës dëgjimore të datës 11.3.2020, e cila u shty për pamundësi objektive të subjektit, subjekti ishte paraqitur në vendin e tij të punës, vendosi të mos e shtynte më në vijim, seancën dëgjimore planizuar me subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Aliaj.

27. Procesi i subjektit të rivlerësimit është kryer nga trupi gjykues, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit, dhe duke i ofruar atij të gjitha garancitë për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 42 dhe 179/b të Kushtetutës, vendimit nr. 17 të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias. Sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, nuk çënon parimet e procesit të rregullt ligjor, ndjekur nga trupi gjykues, i cili ka respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit, në kryerjen e procesit të rivlerësimit.

28. Në datën 6.6.2020, nëpërmjet postës elektronike, dhe nëpërmjet protokollit të institucionit më 8.6.2020, subjekti paraqiti kërkesë për përjashtim të trupit gjykues, dhe arsyet ligjore për këtë kërkesë

29. Në vijim të kësaj kërkesë u caktua me short një trup tjetër gjykues¹⁰, i cili pas vlerësimit të shkaqeve dhe dokumentacionit¹¹ të paraqitur nga subjekti në datë 10.6.2020 vendosi¹²: *“mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues, si të pabazuar në ligj dhe në prova”*.

Subjekti u njoftua për këtë vendim nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 12.6.2020.

30. Në datën 15.6.2020, subjekti paraqiti përsëri dokumentacion¹³ i cili u administrua nga Komisioni si dhe kërkesë për përjashtim trupi gjykues, me të njëjtat shkaqe ligjore si më parë.

31. Subjekti u njoftua nga Komisioni, nëpërmjet komunikimit elektronik nga info@kpk.gov.al, të datës 15.6.2020 se kërkesa për përjashtim të trupit gjykues, është e përsëritur dhe se Komisioni ka disponuar me vendimin e datës 10.6.2020, duke e rrëzuar kërkesën si të pabazuar në ligj dhe në prova.

31.1 Në datën 15.6.2020, subjekti paraqiti pretendimin se kërkesa për përjashtim të trupit gjykues nuk kishte analizuar dhe nuk ishte shprehur për kallzimin penal të paraqitur nga ai të depozituar në Prokurorinë e Posaçme dhe në Prokurorinë e Shkallës së Parë Tiranë, për trupin gjykues. Sa më sipër pretenduar nga subjekti, ishte jashtë objektit të veprimtarisë së Komisionit.

⁸ I aftë për punë, datë 6.6.2020.

⁹ Nëpërmjet postës elektronike të datës 9.3.2020.

¹⁰ Me vendimin nr. **, datë 8.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹¹ Dokumentacion bashkëlidhur kërkesës për përjashtim paraqitur në formë elektronike.

¹² Me vendimin e ndërmjetëm të datës 10.6.2020.

¹³ Kallzim penal me nr. **** prot date 15.06.2020 shoqëruar me mandat postar të datës 08.06.2020 si dhe shkresë date 11.06.2020 lëshuar nga Kryetarja e degës së buxhetit të Gjykatës së Apelit Vlore, Urdhër date 10.03.2020 lëshuar nga Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlore, urdhër të datës 24.03.2020 lëshuar nga Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlore fletëdalje lëshuar nga spitali C, shkresë me nr. ** prot date 08.06.2020 lëshuar nga Kancelarja e Gjykatës së Apelit Vlore, dhe fotokopje të akteve shkresë date 29.04.2020 lëshuar nga Kryetare e Gjykatës së Apelit Vlore, vendim nr. ** datë 10.03.2020 raport për paaftësi të përkohshme në punë me nr. regj ***, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, observacion datë 14.06.2020, raport për paaftësi të përkohshme me nr. regj ****, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë

32. Në datën 12.6.2020 subjekti u njoftua¹⁴ se seanca për shpalljen e vendimit do të zhvillohej në datën 15.6.2020, ora 13:15, në të njëjtin vend të njoftuar më parë.

33. Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 15.6.2020, subjekti paraqiti raport për paaftësi të përkohshme në punë me nr. **** regj., të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë me diagnozën “angina folikulare” pushim tri ditë, prej datës 15.6.2020 – 17.6.2020¹⁵.

II. SEANCA DËGJIMORE

34. Në datën 5.6.2020 u zhvillua seanca dëgjimore në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit në seancë, duke mos shfrytëzuar të drejtën ligjore të përfaqësimit me një përfaqësuesi ligjor, sikundër iu kërkua nga Komisioni.

35. Seanca dëgjimore e datës 5.6.2020, u ndërpre, për të vijuar në datën 15.6.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

36. Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti nuk është treguar bashkëpunues, duke u përpjekur të shtyjë seancën dëgjimore dhe të ndikojë në vonesën e procesit të tij të rivlerësimit. Në referim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, kjo sjellje është konsideruar nga Komisioni në vlerësimin përfundimtar të tij, si subjekt rivlerësimi.

36.1 Sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, ka vështirësuar punën e trupit gjykues në kryerjen e procesit të rivlerësimit. Në analize të saj, trupi gjykues arrin në konkluzionin se kjo sjellje ndaj procesit të rivlerësimit, nga ana e subjektit të rivlerësimit, përmbush kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke cënuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

IV. VLERËSIMI I PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

37. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përfundim të të cilit ka konstatuar se për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Aliaj:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

38. Komisioni, pas kryerjes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultatit, për sa rezultoi nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni.

38.1 Në përgjigje të barrës së provës subjekti disa herë ka referuar dhe pretenduar se: “Arsyetimi i dhënë nga ana juaj është në kundërshtim me pjesën përshkruese të arsyetimit të vendimit gjyqësor

¹⁴ Posta elektronike të datës 12.6.2020.

¹⁵ I aftë për punë, datë 18.6.2020.

*të formës së prerë nr. **(***)*, datë 4.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe me bilancin e rezultuar nga akt-ekspertimi kontabël i cituar në këtë vendim.”*

39. Trupi gjykues, së pari vlerësoi të analizojë në vendim, pretendimin ligjor të mësipërm të ngritur nga subjekti, duke arsyetuar si më poshtë vijon:

39.1 Sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, është detyrë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të hetojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

39.2 Në rastin në fjalë, referuar nga subjekti, konstatohet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, filloi një hetim penal në vitin 2015, pas një raporti të ILDKPKI-së ku evidentoheshin një sërë mangësish, që rezultonin nga deklaratimet periodike të subjektit Petrit Aliaj.

39.3 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan. me vendimin e datës 18.01.2016, pushoi çështjen penale nr. *** të vitit 2015, në mbështetje të nenit 328,1/b të Kodit të Procedurave Penale, duke konkluduar se: “ *ky procedim penal nuk mund të vazhdojë pasi nuk u bë e mundur të provohet se faktet objekt hetimi përbejnë veprë penale parashikuar nga nenet 287 dhe 257/a/2 të Kodit Penal, për shkak të mosplotësimit të elementeve objektive e subjektive të këtyre veprave penale”*

39.3 Subjekti i rivlerësimit, e ankimoi këtë vendim, duke pretenduar se prokurori duhet të kishte konkluduar se fakti nuk egziston, sipas nenit 328 pika 1 gërma a e Kodit të Procedurave Penale.

39.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin gjyqësor nr. **(***)*, datë 4.7.2016, ka vendosur, se nuk ndodhej para mosegzistencës së faktit, por para mungesës së të provuarit në lidhje me akuzat, duke arritur në konkluzionin se vendimi i prokurorit duhej lënë në fuqi, dhe duhej rrezuar ankimi i z. Aliaj.

39.5 Është e nevojshme të vlerësohet nëse vendimi i Gjykatës ezaurohet me një vendim të formës së prerë (“*res iudicata*”), dhe nëse mund të bëhet objekt i “vlerësimit të pasurisë” në kuadrin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas Ligjit 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës.

39.6 Vendimi gjyqësor nr. **(***)*, datë 4.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është marrë në zbatim të nenit 329 të Kodit të Procedurave Penale në atë kohë. Ky nuk është një vendim për themelin e çështjes, prandaj nuk mund të konsiderohet si gjykim në kuptimin e nenit 7 të Kodit të Procedurës Penale.

39.7 Vendimi gjyqësor nr. ***(***)*, datë 4.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është vendim lidhur me ligjshmërinë e vendimit të Prokurorisë në rastin specifik dhe në kohën specifike kur është dhënë vendimi – siç parashikon Vendimi Unifikues 2/2013 i Gjykatës së Lartë. **Në fakt, sipas legjislacionit shqiptar, prokurori nuk e ka të ndaluar të rihapë hetimin bazuar te të njëjtat fakte, për të cilat është pushuar hetimi i mëparshëm.**

40. Trupi gjykues vlerëson gjithashtu të nënvizojë se objekti, standardet e provës dhe qëllimi i procesit të Vettingut janë të ndryshme nga ato të hetimeve penale.

41.Më konkretisht:

- procesi i *Vettingut* është konceptuar si një ushtrim i jashtëzakonshëm, qëllimi i të cilit është të analizojë, *ex novo* – përmes një kontrolli të plotë – të gjitha pasuritë dhe të gjithë jetën financiare të magjistratëve shqiptarë, me synimin që të konstatohet nëse janë përfutur në mënyrë të ligjshme;

- ky vlerësim, sipas Kushtetutës së Shqipërisë, është nën kompetencën ekskluzive të organeve të *Vettingut* (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit). Kështu, ato kanë detyrimin dhe të drejtën të analizojnë specifikisht një për një pasuritë që subjektet zotërojnë;

- procesi i *Vettingut* nuk synon të konstatojë përgjegjësi penale: rezultati mund të jetë vetëm masa disiplinore;
- në procesin e *Vettingut* subjekti duhet të justifikojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë së vet, ndërsa në hetimet penale është ekskluzivisht detyrë e prokurorisë që të provojë të gjithë elementët përbërës të veprës penale.

41.2 Neni 126 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sqaron se madje edhe një vendim i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit nuk pengon hetimin e mëtejshëm mbi të njëjtat fakte, me qëllim për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magjistratit. Kështu, *a fortiori*, procesi i jashtëzakonshëm i natyrës administrativo-disiplinore, i rivlerësimit të pasurisë së subjektit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 nuk përjashtohet dhe nuk paragjykohet nga vendimi gjyqësor nr. ***(****), datë 4.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

42. Për sa më sipër trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se trupi gjykues nuk duhet të shprehet për faktet e referuara në vendimin nr. *(*****), datë 4.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është i pabazuar në ligj.**

43. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku ka rezultuar, si vijon:

44. Për banesën private – e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi prej 105 m², e ndërtuar mbi tokën me sip. 200 m², në Sarandë, nga ku 2/3 banesë në pronësi të z. Petrit Aliaj; 1/3 banesë pasuri bashkëshortore Petrit Aliaj dhe K.A, ku vlera e saj sipas koston së ndërtimit të vitit 2004 është 10.150.116 (dhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

44.1 Pasuria me nr. ****, z. k. ****, referuar vërtetimit hipotekor, datë 17.2.2012, lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë. Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshorten. Banesa ka një vlerë të rivlerësuar sipas ZVRPP-së Sarandë, në shumën 21.888.320 (njëzet e një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet) lekë.

44.2 Lidhur me vlerën e investimit në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se: “*Banesa është ndërtuar nga vëllai Xh. A dhe burri i motrës M. A, S.K, ku motra ime përveç krahut të punës së bashkëshortit të saj S.A, nuk ka kontribuar me vlerë monetare në banesën në bashkëpronësi. Vlera sipas koston së ndërtimit për vitin 2004 në shumën 10.150.116 (dhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë. Te vlera e koston së ndërtimit, 10.150.116 (dhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë përfshihet dhe kostoja e fuqisë punëtore e gjithë punimeve të kryera në banesën në bashkëpronësi, e cila është në masën 17 % të vlerës së përgjithshme të koston së ndërtimit.*

44.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 subjekti nuk ka deklaruar të drejtat për pjesën takuese të tij, sipas lejes së ndërtimit dhënë me vendimin nr. **, datë 10.9.2003.

44.4 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti nuk ka deklaruar të drejtat e tij mbi ndërtimin e kryer dhe as kontributin e tij në vlerën e ndërtimit. Në këtë deklaratë subjekti deklaroi se: “*Kam aplikuar në datën 10.2.2005, në ZVRPP-në Sarandë mbi një objekt në bashkëpronësi me shtetasit Xh. A dhe M.K*”.

44.5 Nga hetimi¹⁶ i Komisionit rezulton se subjekti ka të regjistruar në ASHK-në Sarandë pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. **, f. **, e llojit truall me sip. 200 m² dhe ndërtesë me sip. 105 m².

44.6 Komisioni administroi praktikën bashkëlidhur shkresës së ZVRPP-së Sarandë¹⁷ ku rezultoi se me aktin e dhurimit me nr. ****, datë 31.1.2012, shtetasit Xh.A dhe M.K(A) i dhurojnë subjektit të rivlerësimit pjesën e tyre takuese në këtë pasuri.

44.7 Në vijim, Komisioni i kërkoi¹⁸ ASHK-së dokumentacionin historik të depozituar lidhur me pasurinë truall dhe ndërtesë, në vijim të së cilës¹⁹ informoi se në datën 16.1.2012 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kërkesë për bashkim pasurish (të tokës truall dhe ndërtesës), në cilësinë e pronarit të këtyre pasurive.

44.8 Nga administrimi i praktikës bashkëlidhur nuk u gjet akt përfaqësimi apo prokurë që subjekti të kishte paraqitur për të vepruar para zyrës së ASHK-së Sarandë (ish-ZVRPP-ja) në emër dhe për llogari edhe të dy bashkëpronarëve të tjerë (M. A e motra dhe Xh. A i vëllai).

44.9 Lidhur me vlerën e investimit për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* se: *“Vlera e ndërtimit është sipas kostos së ndërtimit të vitit 2004 në shumën 10.150.116 (dhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, e cila përputhet me deklaratimet e dhëna para ILDKPKI-së.”*

Lidhur me burimet e krijimit

45. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar se: *“Për ndërtimin e kësaj banese private të ndërtuar nga vetë bashkëpronarët Petrit Aliaj, Xh. A, M.K (A), me kontratën e huamarrjes nr. ***, datë 22.7.2000, z. Petrit Aliaj ka marrë hua nga shtetasi P.K shumën prej 25.000.000 (njëzet e pesë milionë) dhrahmi greke të barasvlershme me 10.000.000 (dhjetë milionë) lekësh dhe se ky shtetas e ka të siguruar këtë shumë nga aktiviteti i tij i biznesit në shtetin grek.*

Biznesi i shtetasit P. K në shtetin grek rezulton nga shkresa njoftim drejtuar zyrës së tatimeve AG A, lëshuar në datën 29 dhjetor 1999 nga Ministria e Financave të shtetit grek, shkresa ‘shënim për pagesë’, datë 30.1.2015, lëshuar nga Zyra e Tatimeve AG A.”

45.1 Deklarimi në *Vetting* për burimin e krijimit nuk përputhet me deklarin në datën 1.11.2004 datë kur subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja lidhur me këtë pasuri, ku ka deklaruar se: *“Pjesën që kam kontribuuar unë në këtë shtëpi janë lekët nga shitja e shtëpisë së Delvinës dhe një pjesë nga lekët që kam marrë hua. Nga viti 1998 deri në 2003 ka qenë vetëm trualli mbi të cilin është hedhur skelet betoni në sip 100 - 123 m². Kjo shtëpi nuk është përfunduar, si dhe nuk është e regjistruar në zyrat e regjistrimit. Vlehtë e saktë e kësaj ndërtese do të dalë në momentin e regjistrimit, pasi siç e shpjegova ne e kemi ndërtuar vetë.”*

45.2 Nga hetimi ka rezultuar se me kontratën nr. ***, datë 22.7.2000, huadhënësi P. K i jep hua subjektit të rivlerësimit shumën 25.000.000 (njëzet e pesë milionë) dhrahmi greke me afat 6-vjeçar, me interes 5 %, të cilat sipas kësaj kontrate janë dorëzuar jashtë zyrës noteriale. Shlyerja e kësaj shume do të kryhej në përfundim të çdo viti ku huamarrësi do t’i kthente huadhënësit interesat mujore prej 5 % në çdo muaj.

45.3 Nga hetimi ka rezultuar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* të krijuar nga huamarrja e shtetasit P. K në vitin 2000.

45.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të

¹⁶ Shkresë nr. **** prot., datë 23.4.2019, e ZVRPP-së Sarandë.

¹⁷ Dosje e ILDKPKI-së.

¹⁸ Shkresë nr. **** prot., datë 26.7.2019, drejtuar ASHK-së, Drejtoria Vendore Sarandë.

¹⁹ Shkresë nr. **** prot., datë 9.8.2019.

tjera për të provuar të kundërtën për deklarime kontradiktore që rezultuan lidhur me burimin e përdorur për ndërtimin e shtëpisë së banimit, mosdeklarimin nga subjekti të gjendjes *cash* të krijuar nga huamarrja e shtetasit P.K; paprovueshmërinë me dokumentacion ligjor të të ardhurave të ligjshme të huadhënësit, bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

46. Subjekti, në përgjigjet e tij, shprehet: *“Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, datë 17.3.2004, të ILDKPKI-së e cila i përket deklaratës periodike vjetore të vitit 2003 dhe me konkretisht të formularin A-T ‘Detyrime financiare ndaj personave juridik dhe fizik’ që përkon me periudhën e deklarimit, 22.7.2000 - 31.12.2003’, kam deklaruar kontratën e huamarrjes të lidhur me shtetasin P. K dhe shumën 25.000.000 dhrahmi.*

*Në f. ** – ** të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. **(****), datë 4.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kjo e fundit rezulton të ketë arsytuar në lidhje me këtë pikë se: ‘Nga të dhënat e analizuar në tërësi rezulton se deklarimi i subjektit është korrekt, pasi subjekti Petrit Aliaj i ka deklaruar pronat që ka pasur në pronësi (tokë, shtëpi, mjet) apo posedim dhe marrëdhënie me të tretët (kontratë huaje), duke paraqitur argumente dhe dokumentacion justifikues, pavarësisht faktit nëse i është kërkuar apo është administruar nga institucioni përkatës një dokumentacion i tillë.*

*Arsyetimi i dhënë nga ana juaj se kam rezultuar në një balance negative në shumën – 7.490.286 është në kundërshtim me bilancin e rezultuar nga aktekspertimi kontabël i cituar në pjesën përshkruuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. **(****), datë 4.7.2016, të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Elbasan (shihni f. **-**, të vendimit).”*

46.1 Subjekti paraqiti në cilësinë e provës²⁰ dokumentin me përmbajtje: deklarime tatimore vjetore për vitet 1997 - 2000 për huadhënësin P. K.

Analiza e fakteve dhe ligjit

47. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

47.1 Në pikën 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*. Në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*.

47.2 Trupi gjykues, nga analiza e fakteve, provave dhe shpjegimeve të dhëna vlerëson se në lidhje me burimet e ligjshme të shtetasit P.K, burim financimi të huas në vlerën 25.000.000 dhrahmi, bazuar në provat shkresore që u referohen të ardhurave të shtetasit P. K deri në vitin 2000 – ky i fundit, viti i huadhënies, vlerëson se dokumentacioni ligjor provues i depozituar nga subjekti, provon të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, shtetasit P.K, deri në momentin e dhënies së huas.

47.3 Trupi gjykues vlerësoi të analizojë edhe destinacionin e huas së marrë nga ky shtetas.

²⁰ Nëpërmjet postës elektronike të datës 2.6.2020.

47.4 Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2003 vlerën e provës, në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile.

47.5 Në analizë të deklaratës periodike të vitit 2003 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* të përfituar nga huamarrja nga shtetasi P.K, por ka deklaruar vetëm kontratën e huamarrjen në formularin A-**, ku shuma e marrë hua nga ky shtetas është përshkruar te rubrika e arsyeve të krijimit të detyrimit **“Për të përdorur për të blerë tokë arë dhe për të bërë ndërtim shtëpi private.”**

47.6 Trupi gjykues çmon të vlerësojë deklarinimin e vitit 2003 në mënyrë integrale edhe me sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në datën 1.11.2004 në ILDKPKI se: *“Nga viti 1998 deri në vitin 2003 ka qenë vetëm trualli mbi të cilin është hedhur skelet betoni në sip 100 - 123 m².*

47.7 Për sa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* të mbetur nga huamarrja e shtetasit P. K në vitin 2000, huaja e marrë në vitin 2000 nuk provohet të ketë shërbyer për ndërtimin e banesës objekt hetimi administrativ në vitin 2004.

47.8 Kostoja e ndërtimit të banesës në vitin 2004 nuk u arrit të provohet nga subjekti i rivlerësimit se është mbuluar me të ardhura të ligjshme, për sa nuk është provuar se huaja e marrë në vitin 2000 është përdorur për këtë investim.

47.9 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të ndërtimit të kësaj pasurie në vitin 2004, në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

48. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka shlyer, ndër vite, këtë hua, si vijon:

Për sa i përket shlyerjes së huas gjatë vitit 2006

48.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka shlyer në vitin 2006 shumën 60.000 USD, ndër të tjera, nga të ardhurat nga avokatia si vijon:

“Të ardhurat në shumën 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD, përfituar pasi nga data 3.1.2005 – 4.3.2006, kam ushtruar profesionin e konsulentit juridik-avokat pranë firmës SH.R.S.F “B.CO”, Delvinë dhe “V.B”, Delvinë, dhe kam përfituar për shërbimin juridik, shpërblimin prej 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD. Shuma prej 47.000 (dyzet e shtatë mijë) USD ka shërbyer për kthimin e një pjese të huas së dhënë nga shtetasi P. K.”

48.2 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka shlyer në vitin 2006 shumën 60.000 USD, ndër të tjera, nga nga gjendje *cash* në banesë në shumën prej 280.435 (dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh me burim nga mbyllja e depozitës bankare rreth vitit 2002 – 2003,

48.1.1 Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi deklarinimet në raport me provat që mbështesin këto deklarime, bazuar në legjislationin tatimor në fuqi, konstaton se:

48.1.2 Deklarimi në *Vetting* i afatit kohor 2005 – 2006, kur sipas deklarinimit janë përfituar të ardhurat nga avokatia, vjen në kundërshtim me deklarinimin periodik vjetor të vitit 2006 në të cilin subjekti deklaroi se ka përfituar nga data 3.1.2005 – 4.3.2005 të ardhurat në shumën 47.000 (dyzet e shtatë mijë) USD me burim nga ushtrimi i profesionit të avokatit.

48.1.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 subjekti ka deklaruar se ka shlyer detyrimin në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) USD shtetasit P.K, pa përcaktuar burimin e shlyerjes së këtij detyrimi.

48.1.4 Përfitimi i këtyre të ardhurave dhe ushtrimi i funksionit të avokatit nuk provohen me dokumentacion ligjor provues.

48.1.5 Me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2019, shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2019 dhe shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2019, ka rezultuar se z. Petrit Aliaj nuk ka pasur biznes të regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë.

48.1.6 Referuar deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2003 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në shumën prej 280.435 (dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh me burim nga mbyllja e depozitës bankare në emër të bashkëshortes së tij në Bankën e Kursimeve.

48.1.7 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, për sa më sipër subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e :

- për sa nuk provohet përfitimi i të ardhurave në shumën 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD nga shërbimi i konsulencës në shoqëritë “B.CO”, Delvinë dhe “V.B” dhe pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës;
- për sa nuk ka deklaruar në deklaratën e parë të vitit 2003 gjendje *cash* në banesë në shumën prej 280.435 (dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh me burim nga mbyllja e depozitës bankare rreth vitit 2002 – 2003, në emër të bashkëshortes së tij në Bankën e Kursimeve të shtetit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

49. Subjekti, në përgjigjet e tij, shprehet: *“Lidhur me arsyetimin e dhënë nga ana juaj se të ardhurat në shumën 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD me burim shërbim konsulence juridike për shoqërinë ‘B &CO’, Delvine dhe ‘V.B’ nuk provohen me dokumentacion ligjor, po iu parashtroj se:*

*Në f. **të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. **(****), datë 4.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kjo e fundit rezultoi të ketë arsyetuar në lidhje me këtë pikë se: ‘Nga të dhënat e analizuar në tërësi rezultoi se Bashkia Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2015, ka përcjellë informacion e konfirmuar faktin se gjatë vitit 2005 nga z. Petrit Aliaj është ushtruar profesioni avokatit.*

Shoqëritë ‘V.B’ sh.p.k. dhe ‘B& CO’ sh.p.k. me shkresën datë 3.8.2015, kanë informuar se kanë pasur të punësuar si konsulent të jashtëm shtetasin Petrit Aliaj, duke referuar edhe pagesën përkatëse të ofruar. Iu kam paraqitur për këtë pikë dhe vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Sarandë për taksat e paguara si biznes i vogël dhe vërtetimet shoqërisë ‘V.B’ sh.p.k., dhe ‘B& CO’ sh.p.k., të cilat po jua riparaqes.”

49.1 Për të mbështetur shpjegimet e tij, subjekti paraqiti vërtetimin nr. *** prot., datë 31.7.2017, e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Sarandë, bashkëlidhur të cilit ishte mandatpagesa e kryer në datën 17.4.2009, me anë të së cilës ishte shlyer taksa e biznesit të vogël për vitin 2005, në vlerën 60.000 lekë.

Analiza e fakteve dhe ligjit për të ardhurat e vitit 2006 përdorur për shlyerje huaje

(i) për të ardhura në shumën 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD nga shërbimi i konsulencës

50. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

50.1 Vlerësimi i mjaftueshmërisë së burimeve të subjektit të rivlerësimit për të krijuar pasuritë, për efekt të kontrollit në procesin e rivlerësimit, fillon me verifikimin e **burimit ligjor** e më pas financiar, që subjekti ka detyrimin të deklarojë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit

50.2 Referuar legjislacionit të kohës, për kohën kur subjekti pretendon se ka ushtruar profesionin e avokatit, ky profesion ushtohet pasi individët aplikojnë dhe regjistroheshin në organet tatimore përkatëse, duke deklaruar aktivitetin që ushtronin.

50.3 Legjislacioni tatimor nuk ka pasur parashikime ligjore për kategori personash që mund të ushtronin veprimtari ekonomike, pa u regjistruar më parë në administratën tatimore, pra profesioni i avokatit ka pasur të gjitha detyrimet për **regjistrim** si gjithë personat e tjerë.

50.4 Komisioni vlerëson se për sa sipër arsyetuar, lidhur me verifikimin e **burimit ligjor** dokumentacioni i depozituar në cilësinë e provës, vërtetim nr. **** prot., datë 31.7.2017, i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Sarandë dhe mandati bankar nuk provojnë regjistrimin e aktivitetit të avokatisë, regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, në vitin 2005.

-Dokumentacioni i depozituar në cilësinë e provës, vërtetimi nr. *** prot., datë 31.7.2017, i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Sarandë, i cili referuar mandatit bankar provon kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore **për vitin 2005 vetëm në vitin 2009** (pas 4 vitesh)nuk provon ushtrimin e aktivitetit të avokatisë të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2005.

-mandati i “Raiffeisen Bank” nuk konsiderohet provë, pasi banka luan vetë rolin e agjentit për të paguar tatimet, por nuk vërteton se ato janë paguar.

-mospërputhja e konstatuar në deklaratimet e subjektit për kohën e përfitimit të këtyre të ardhurave deklaruar në *Vetting*, për vitet 2005 - 2006 e në deklarin periodik vjetor të vitit 2006 periudha nga data **3.1.2005 – 4.3.2005**, vlerësohet gjithashtu nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor,për sa gjatë viteve subjekti ka pretenduar kohë të ndryshme të ushtrimit të këtij aktiviteti.

-korrespondenca me Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë, sipas të cilës z. Petrit Aliaj nuk ka pasur biznes të regjistruar përbën provë të plotë shkresore, në kuptim të ligjit, për të vërtetuar se subjekti nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore dhe për rrjedhojë provon se të ardhurat nuk janë të ligjshme.

50.5 Trupi gjykues për sa më sipër arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë përdorimin e shumës 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD nga shërbimi i konsulencës si burim për shlyerjen e huas në vitin 2006, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

(ii)për të ardhura në shumën 280.435 lekë gjendje *cash* në banesë

50.6 Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2003 vlerën e provës, në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile për të provuar përdorimin e shumës prej 280.435 (dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh, si burim për shlyerjen e huas në vitin 2006.

50.7 Për sa nuk ka deklaruar në deklaratën e parë të vitit 2003 gjendje *cash* në banesë në shumën prej 280.435 (dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh me burim nga mbyllja e depozitës bankare në emër të bashkëshortes së tij në Bankën e Kursimeve, kjo shume nuk mund të ketë shërbyer për shlyerjen e huas në vitin 2006.

50.8 Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë përdorimin e shumës prej 280.435 (dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh si burim për shlyerjen e huas në vitin 2006, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa i përket shlyerjes së huas gjatë vitit 2007

51. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se i ka shlyer shtetasit P. K shumën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) USD, shumë e cila i është dhënë nga vëllai Xh.A, i cili e ka të siguar këtë

shumë nga punësimi në emigracion. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.7.2015, të shtetasve Xh. A dhe M.A.

50.1 Mbi bazën e deklaratës noteriale nr. ****, datë 5.7.2015, shtetasi Xh.A deklaroi se: *“i ka dhënë vëllait Petrit Aliaj shumën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) USD, që ka shërbyer për shlyerjen e borxhit shtetasit P.K, si detyrim për ndërtimin e shtëpisë në bashkëpronësi, e cila është ndërtuar nga tre bashkëpronarët”*.

50.2 Subjekti ka sqaruar në përgjigje të pyetësorit të datës 3.7.2019, se: *“...shuma prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) USD i është dhënë nga i vëllai Xh.A dorazi në vitin 2007, ku edhe në këtë vit është kryer shlyerja e saj te shtetasi P.K”*, duke sqaruar lidhur me burimin e kësaj shume, se i vëllai Xh. A e ka siguruar nga punësimi si emigrant në shtetin grek.

50.3 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultatit, për sa nuk provohet me dokumentacion ligjor provues ligjshmëria e shumës 15.000 USD.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

51. Subjekti, në përgjigjet e tij, shprehet: *“Lidhur me arsyetimin e dhënë nga ana juaj se nuk provohet me dokumentacion ligjor provues sa pretendohet nga subjekti lidhur me pagesën e shumës 15.000 USD (dollarë), po iu parashtroj sa më poshtë:*

Iu kam paraqitur në cilësinë e provës shkresore deklaratën e lëshuar nga shtetasi grek N.S, i cili ka konfirmuar marrëdhëniet e punës së vëllait Xh. A në shtetin grek.”

Analiza e fakteve dhe ligjit për të ardhurat e vitit 2007, përdorur për shlyerje huaje

52. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

52.1 Të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për punësimin e personit të lidhur, vëllait Xh.A, në Greqi, nuk plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si pasuri të ligjshme, bazuar në ligjin nr. 84/2016, pasi për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhura të ligjshme vetëm ato të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Deklarata noteriale referuar si provë nga subjekti nuk përmban të dhëna për sa i përket pagimit të detyrimeve tatimore.

52.2 Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave. Trupi gjykues vëren se argumenti i subjektit të rivlerësimit se ka paraqitur në cilësinë e provës shkresore deklaratën e lëshuar nga shtetasi grek N.S, i cili ka konfirmuar marrëdhëniet e punës së vëllait Xh. A në shtetin grek, bie ndesh me pikën 3, të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si dhe me pikën 21 të Udhëzimit të ILDKPKI-së, nr. 4095, datë 10.10.2016.

52.3 Këto akte ligjore dhe nënligjore kërkojnë nga subjektet e rivlerësimit dhe nga institucionet e rivlerësimit që për të ardhurat e deklaruara, subjektet e rivlerësimit, persona të tjerë të lidhur me ta, kur këta të fundit janë në kushtet e pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, të provojnë me dokumentacion ligjor ligjshmërinë e të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to.

52.4 Përveç sa më sipër, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë deklarin periodik të vitit 2007, ku subjekti ka deklaruar se si burim për shlyerjen e huas në këtë vit kanë shërbyer të ardhurat e tij nga paga e marrë për 15 muaj që ka fituar nga gjyqi në Gjykatën e Lartë dhe nga kursimet familjare, arrin në përfundimin se subjekti ka ndryshuar deklarin në *Vetting* në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e huas në vitin 2007.

Për sa i përket shlyerjes së huas gjatë vitit 2008

53. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se i ka shlyer shtetasit P. K shumë prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) USD, shumë e cila i është dhënë hua pa interes nga babai M.A, i cili e ka të siguruar këtë shumë nga vëllai i tij S. A.

53.1 Mbi këtë deklaram, Komisioni administroi deklaratën noteriale nr. ****, datë 5.7.2015, të paraqitur nga subjekti në ILDKPKI, sipas së cilës babai i subjektit, z. M.A, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... *shuma prej 25.000 USD i është dhënë prej meje djalit tim Petrit Aliaj për shlyerjen e borxhit shtetasit P. K. Saktësoj faktin se kam pasur dy vëllezër të arratisur që prej vitit 1944 dhe në vitet 1992 – 1995 vëllai im i quajtur S.A ka ardhur disa herë nga Greqia dhe nga Tirana dhe fillimisht më ka sjellë një shumë të madhe lekësh në monedhë dollarë, ku një pjesë të kësaj vlere prej 150.000 USD ia kam bërë të ditur djalit Petrit Aliaj. Për shkak të marrëdhënieve të posaçme ndërmjet R.A dhe xhaxhait S.A, shuma e dhurimit nuk ka qenë e nevojshme të kryhej me aktdhurimi dhe është e pamundur objektivisht për t’iu paraqitur provë shkresore nga xhaxhai S. A lidhur me këto të ardhura dhe burimin e tyre për shkak të vdekjes së tij në vitin 2009”.*

53.2 Në vijim, në datën 27.12.2016, z. M. A ka lëshuar një deklaratë tjetër me qëllim saktësimin e kushteve të huas së dhënë subjektit, ku deklaroi se vlera prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) USD i është dhënë hua subjektit pa interes dhe pa afat.

53.3 Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të dhuruara, për sa nuk provohet me dokumentacion ligjor provues mundësia financiare e huadhënësit, z. M.A, për shumën e dhënë subjektit në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) USD.

Qëndrimi i subjektit

54. Subjekti shprehet se: “*Lidhur me arsyetimin e dhënë nga ana juaj se nuk provohet me dokumentacion ligjor provues mundësia financiare e huadhënësit z.M.A për shumën e dhënë subjektit në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) USD dhe se subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të vlerave monetare të dhuruara nga xhaxhai i tij, po iu parashtroj sa më poshtë:*

Në rastin konkret, duke vlerësuar në tërësi të gjitha rrethanat e çështjes dhe pamundësisë nga ana ime për të paraqitur dokumentacionin për të ardhurat e ligjshme të xhaxhait tim, duhet zbatuar neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ në të cilin parashikohet shprehimisht: ‘Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor’.

*Në f. ** të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ** (****), datë 4.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kjo e fundit rezulton të ketë arsyetuar në lidhje me këtë pikë se: deklarimi i marrë shtetasit M. A (babait) provon që shuma e parave i është dhënë hua subjektit dhe nuk provohet e kundërta e vënies në posedim të kësaj shume në mënyrë të kundërligjshme, gjithashtu shtetasi M. A ka paraqitur e parashtruar që në periudhën përkatëse përpara ILDKPKI-së, të dhëna të posedimit të parave cash në formën e gjendjes rezervë dhe se nga institucioni nuk është kërkuar apo investiguar më tej lidhur me këtë fakt duke e konsideruar të mirëqenë”.*

54.1 Subjekti paraqiti në cilësinë e provës: vërtetimin datë 1.11.2016, lëshuar nga kryeplaku i fshatit Mazhan për të vërtetuar faktin e arratisjes së shtetasit S. A në vitin 1944 jashtë vendit, në

SHBA dhe Australi dhe se me ardhjen e demokracisë ka ardhur në Shqipëri disa herë në fillim të viteve '90; shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2020, lëshuar nga komisarati i policisë kufitare aeroporti Rinas, ku citohet se: “Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, shtetasi S. A, i vitlindjes 1920 nuk figuron i regjistruar. Për sa i përket hyrje-daljeve për periudhën e kërkuar (janar 91 – dhjetor 1995, nuk i disponojmë pasi regjistrat kanë afat ruajtjeje deri në 10 vjet)”.

Analiza e fakteve dhe ligjit për të ardhurat e vitit 2008, të përdorura për shlyerje huaje

55. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ arsyetën se:

55.1 Lidhur me deklarinimin e subjektit mbi pamundësinë objektive për të paraqitur provë shkresore nga xhaxhai S.A për të provuar të ardhurat dhe burimin e tyre për shkak të vdekjes së tij në vitin 2009, Komisioni vlerëson se subjekti nuk është në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e të ardhurave të xhaxhait me arsyetimin e vdekjes të tij, në kuptim të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

55.2 Në rastin konkret, vdekja e të ndierit, xhaxhait të subjektit është një fakt juridik, i cili nuk lidhet dhe as nuk kushtëzon provueshmërinë e të ardhurave të ligjshme, të deklaruara rregullisht në institucionet kompetente të vendit, ku janë përfutur nga xhaxhai i subjektit dhe për të cilat janë paguar tatimet në kohën e kryerjes së dhurimit. (nje nga vendet banojnë edhe vajzat e subjektit)

55.3 Pika 2, e nenit 32, e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.”

55.4 Në konkluzion të analizës ligjore të mësipërme trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e mosjustifikimit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave, të marra hua në vitin 2008.

Në konkluzion subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e huas ndër vite, shtetasit P. K, deklaruar në deklaratën *Vetting* sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

56. Në lidhje me truallin me sip. 200 m², mbi të cilin është ndërtuar kjo pasuri e paluajtshme, rezultoi se ky truall është blerë me kontratën e shitblerjes nr. **, datë 10.12.1998, nga shitësjja E. N, në shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.**

56.1 Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit është hua nga vëllai Xh.A, i cili i ka siguruar këto të ardhura nga emigracioni në Greqi sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 5.7.2015 dhe deklaratës noteriale nr. ****, datë 27.12.2016.

56.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri.

56.3 Në datën 10.12.1998²¹ është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, midis shitëses E.N dhe subjektit, në cilësinë e blerësit, për shitjen e një sipërfaqeje trualli prej 200 m², kundrejt vlerës 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

²¹ Kontrata e ndodhur në Aneksin ** në dosjen e ILDKPKI-së.

56.4 Regjistrimi i kësaj prone është kërkuar nga subjekti para gjykatës kompetente, nëpërmjet kërimit për detyrimin e ZVRPP-së Sarandë për regjistrimin e kësaj kontrate.

56.5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. *** dhe nr. *** regj. datë 20.11.2007, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e ZVRPP-së Sarandë të regjistrojë kontratën e shitblerjes së datës 10.12.1998, për sipërfaqen e truallit prej 200 m².

56.6 Për shkak të konstatimit të regjistrimit të blerjes së pasurisë tokë truall, nëpërmjet përdorimit të mjetit ligjor, padë drejtuar gjykatës, subjektit iu kërkuar shpjegime, në kushtet kur e kishte fituar këtë pasuri nëpërmjet titullit të shitblerjes.

56.7 Subjekti ka shpjeguar²² se: “*Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, e cila me shkresën datë 20.9.2007 ka refuzuar regjistrimin e kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 10.12.1998. Në këto kushte, i është drejtuar në cilësinë e paditësit Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë. Ka qenë në vlerësimin e gjykatës që ka shqyrtuar çështjen që të çmonte nëse ekzistonte ndonjë pengesë ligjore për shqyrtimin e saj, pasi nga ana ime nuk është konstatuar ndonjë pengesë ligjore në referim edhe të nenit 43 të Kodit të Procedurës Civile*”.

56.8 Komisioni ka kërkuar informacion mbi origjinën e kësaj prone dhe, në përgjigje, ASHK-ja Sarandë (ish-ZVRPP-ja) me shkresën nr. *** prot., datë 9.8.2019, ka dërguar historikun e kësaj pasurie, nga administrimi i së cilës lidhur me origjinën e saj, ka rezultuar se me nr. *** akti dhe nr. *** vendimi, datë 27.8.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, shtetasve K dhe E.N u është njohur e drejta e pronësisë mbi një shtëpi banimi dhe sipërfaqe truall prej 1615 m², ndodhur në lagjen nr. *, Sarandë.

56.9 Me kontratën e shitblerjes datë 10.12.1998, këta shtetas i kalojnë subjektit sip. 200 m² truall, nga truallit i mësipërm dhe më pas shtetasi K.N i është drejtuar gjykatës duke kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës për paraqitjen e dokumentacionit në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim KKKP) për kthimin e truallit me sipërfaqe prej 1615 m².

56.9.1 Me vendimin e datës 7.4.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, vendim ku subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e kryesuesit të trupit gjyqësor, është vendosur rivendosja në afat të së drejtës të shtetasit K.N për paraqitjen e dokumentacionit në KKKP.

56.10 Me vendimin e dhënë subjekti në datën 7.4.1999, vendosi rivendosjen në afat të së drejtës për të aplikuar në KKKP shtetasit K.N duke i dhënë atij të drejtën për të përfitur ligjërisht kthimin e truallit me sip. prej 1615 m², me vendimin nr. *, datë 18.1.2000, të KKKP, për pasurinë e paluajtshme nga e cila sip. 200 m², i dispononte vetë subjekti i rivlerësimit.

56.11 Subjekti, lidhur me burimin e krijimit, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë truall, huan nga vëllai i tij, sipas deklaratave noteriale.

56.12 Për të provuar lidhur me burimin e krijimit, bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar, subjekti ka depozituar para ILDKPKI-së dy deklarata noteriale (nr. ****, datë 5.7.2015 dhe nr. ****, datë 27.12.2016), lëshuar nga shtetasit Xh dhe M.A.

56.13 Në deklaratën e parë (datë 5.7.2015) shtetasi Xh.A deklaroi se i ka dhënë subjektit shumën prej 600.000 (gjashtëqind mijë) lekësh për blerjen e sip. 200 m², ndërsa në deklaratën e dytë (datë 27.12.2016), përcaktoi se këtë shumë ia ka dhënë pa interes dhe pa afat.

56.14 Nisur nga këto deklarime, subjektit i është kërkuar të sqarojë lidhur me këtë hua, të provojë me marrjen e kësaj shume, shlyerjen e saj, si dhe të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit.

²² Përgjigje e pyetësorit datë 3.7.2019.

56.15 Në përgjigjet e pyetësorit datë 3.7.2019, subjekti ka sqaruar: “Në datën 10.12.1998 vëllai im Xh.A më ka dhënë hua shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë për blerjen e sipërfaqes së truallit prej 200 m², të ndodhur në qytetin e Sarandës. Kjo hua është dhënë me lekë cash në dorë. Në muajin dhjetor të vitit 2018 i kam shlyer vëllait tim, Xh. A, huan. Huaja është shlyer dorazi, duke i dhënë vëllait, Xh.A, shumën 5.000 (pesë mijë) euro”.

56.16 Subjekti paraqiti, në cilësinë e provës për të provuar mundësinë e huadhënësit, aktin deklarativ datë 2.10.2019, të lëshuar nga shtetasi N. S, sipas së cilës deklarohet prej tij punësimi i z. Xh.A për periudhën 1993 – 2002, me pagën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) dhrahmi/muaj dhe për periudhën 2002 – 2008 me pagën 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro.

56.17 Komisioni, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe vlerësoi provat e paraqitura në tërësi, i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për sa subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e ligjshme të vëllait Xh. A në shtetin grek; dhe për sa nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 lidhur me huan e marrë nga vëllai i tij, z. Xh. A, në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”²³.

56.18 Komisioni i kaloi subjektit gjithashtu barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa rezultoi nga hetimi se subjekti, kishte gjykuar lidhur me çështjen e rivendosjes në afat të të drejtave mbi pasurinë të shtetasve N.

Qëndrimi i subjektit pas kalimit të barrës së provës

57. Subjekti shprehet se: “Për sa i përket vendimit gjyqësor të datës 7.4.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në të cilin unë, subjekti i rivlerësimit, kam qenë në cilësinë e kryesuesit të trupit gjyqësor, theksoj faktin se ky vendim gjyqësor është dhënë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes me shtetasen E.N, ku në aktin noterial ka dhënë pëlqimin dhe shtetasi K.N. Nuk ka qenë në kompetencën e gjykatës të shqyrtojë të drejtat pronësore të këtyre shtetasve. Çështja civile, e gjykuar prej meje, nuk ka lidhje me pasurinë objekt i kontratës së shitblerjes nr. ****, pasi ka qenë me natyrë administrative, pra, nuk kam pasur interes në çështje as unë as bashkëshortja ime.

57.1 Në procesverbalin mbi pyetjen e shtetasit Petrit Aliaj, datë 1.11.2004, të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, f. *, kam deklaruar për truallin me sip. prej 200 m² në vlerën 600.000 lekë, ku lekët e këtij trualli janë marrë hua nga vëllai Xh.A. Pra, e kam përmbushur detyrimin ligjor për ta deklaruar”.

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

58. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

58.1 Në datën 10.12.1998²⁴ është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, midis shitëses E.N dhe subjektit, në cilësinë e blerësit, (në aktin noterial subjekti konfirmon se ka dhënë pëlqimin dhe shtetasi K.N) për shitjen e një sipërfaqeje trualli prej 200 m², kundrejt vlerës 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, vlerë likuiduar jashtë zyrës noteriale.

58.2 Vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit në datën 7.4.1999, nëpërmjet të cilit subjekti i ka njohur të drejtën shtetasit K.N për të rivendosur në afat të drejtën për paraqitjen e dokumentacionit në KKKP është dhënë në kushtet kur:

²³ Vetëm në deklaratën *Vetting*, si dhe në DPV-në e vitit 2017 deklaroi lidhur me detyrimin ndaj z. Xh.A.

²⁴ Kontrata e ndodhur në aneksin ** në dosjen e ILDKPKI-së.

-subjekti ushtronte detyrën e gjyqtarit dhe kishte përfituar prej këtyre shtetasve të drejta mbi sipërfaqen e truallit, pjesë e sipërfaqes për të cilën ai vendosi rivendosjen në afat për z.K.N.

-ushtrimi i funksionit të subjektit si gjyqtar në gjykimin e kësaj çështjeje, vinte në kundërshtim me nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile në vitin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, për sa ky nen parashikonte se: *“Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim.”*

- duke parë rregullimet ligjore në tërësi, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi këtë marrëdhënie dhe veprimet si gjyqtar, nuk bazohen në ligj dhe në fakte, për sa provohet interesi direkt i tij për pasurinë objekt gjykimi nga ana e tij

58.3 Në lidhje me deklarin e subjektit mbi burimin e krijimit për blerjen e këtij trualli.

58.4 Në deklarin periodik vjetor të vitit 2003 subjekti nuk ka deklaruar hua marrë vëllait Xh. A. Trupi gjykues vlerëson të nënvizojë se nuk ka gjurmë të pronësisë të vëllait te ky truall, në të kundërt të sa deklaruar nga subjekti në procesverbalin datë 1.11.2004, të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, se trualli ishte blerë prej tij dhe vëllait.

58.5 Deklarimi i subjektit se ka përmbushur detyrimin ligjor të deklarimit të huas, me sa ka deklaruar në procesverbalin datë 1.11.2004, të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, f. *, ku ka deklaruar se për truallin me sip. 200 m², vlere prej 600.000 lekësh është marrë hua nga i vëllai Xh.A, i cili vijonte të ishte emigrant në kohën e përpilimit të këtij procesverbali, vjen kundërshtim me detyrimet ligjore në fuqi.

58.6 Detyrimi ligjor i subjektit për të deklaruar pasuritë dhe detyrimet ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarin në deklaratat periodike vjetore të çdo pasurie, duke përfshirë edhe detyrimet monetare ndër vite. Nga hetimi administrativ rezultoi se duke filluar nga deklarimi periodik vjetor i vitit 2003 dhe në vitin 2016 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar huan marrë të vëllait Xh. A, apo shlyerjen e saj.

58.7 Në vijim, neni 32 i ligjit nr. 84/2016 parashikoi shprehimisht se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, kishin detyrimin të paraqisnin të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

58.8 Nisur nga rrethanat e faktit të kësaj marrëdhënieje huaje, të pretenduar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, detyrimi i parashikuar pikat 1 dhe 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtrihej mbi të ardhurat e vëllait të tij z. Xh.A, person tjetër i lidhur që rezultonte huadhënës në favor të subjektit të rivlerësimit.

58.9 Deklaratat e lëshuara nga shtetasi N.S, për të provuar punësimin e z. Xh.A nuk provojnë se të ardhurat në çdo rast të vëllait të subjektit janë të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa nuk provojnë pagesën e tatimeve për këto të ardhura.

58.9.1 Deklarata e lëshuar nga shtetasi N.S, ku deklarohet punësimi i z. Xh.A në vitet 2005 - 2008 nuk mbështetet nga verifikimet e sistemit *TIMS*, sipas të cilave nuk rezulton që ky i fundit të ketë kryer udhëtime nga Greqia në Shqipëri dhe anasjelltas.

58.10 Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë e personit tjetër të lidhur, shtetasit Xh. A, për të mbuluar me burime të ligjshme huan dhe, rrjedhimisht, nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të blerjes së pasurisë së paluajtshme truall, si dhe ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit të saj.

59.Trupi gjykues, vlerësoi në mënyrë integrale gjetjet e analizuara në lidhje me **banesë private** – e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi prej 105 m², e ndërtuar mbi tokën me sip. 200 m², në Sarandë, për sa i përket mënyrës së përfitimit të truallit, veprimeve të

subjektit të rivlerësimit gjatë funksionit të tij si gjyqtar deklarimeve kontradiktore për huamarrjen nga i vëllai, mosprovimin e mundësisë financiare të vëllait për huan e dhënë, dhe mosprovueshmërisë së ndërtimit të ndërtesës në vitin 2004 me të ardhura të ligjshme, si dhe pamundësisë financiare për shlyerjen e huas së marrë shtetasit P. K.

59.1 Trupi gjykues, në referim të analizës integrale të gjetjeve më sipër në lidhje me **banesë private** e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi prej 105 m², e ndërtuar mbi tokën me sip. 200 m², në Sarandë, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në pronësi, në kuptim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

60. Trupi gjykues çmon se fakti i pakontestueshëm se subjekti në datën 7.4.1999, vendosi rivendosjen në afat të së drejtës për të aplikuar në KKKP shtetasit K.N duke i dhënë atij të drejtën për të përfituar ligjërisht kthimin e truallit me sip. prej 1615 m², me vendimin nr. *, datë 18.1.2000, të KKKP, për pasurinë e paluajtshme nga e cila sip. 200 m², i dispononte vetë subjekti i rivlerësimit, janë veprime që jo vetëm vijnë në kundërshtim me nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile por e bëjnë të pashmangshme mungesën e besimit të drejtësisë dhe shteti ligjor.

Për sa i përket investimit në bono thesari i shumës 3.000.000 (tre milionë) lekë

61. Burimi i krijimit: në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se burimi kryesor i krijimit të kësaj shume është nga shitja e shtëpisë në Delvinë në shumën 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 300.000 (treqind mijë) lekësh e ka burimin nga depozita bankare (shuma 900.000 nëntëqind mijë lekë) nga punësimi i dy bashkëshortëve²⁵.

61.1 Me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2019, Banka e Shqipërisë konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka çelur depozitë bono thesari në shumën 3.000.000 (tre milionë) lekë në datën 13.12.2012.

61.2 Subjekti ka deklaruar depozitën në DPV-në e vitit 2012, duke deklaruar gjithashtu se kjo depozitë e ka burimin të të ardhurat e tij nga ushtrimi i konsulencës si avokat për periudhën 3.1.2004 – 4.3.2005, në shumën 3.000.000 (tre milionë) lekë mbajtur gjendje *cash* në shtëpi.

61.3 Komisioni verifikoi procesverbalin e datës 29.5.2015, të mbajtur para ILDKPKI-së, kur është pyetur lidhur me burimin e depozitës, subjekti ka sqaruar se: “*Burimi i kësaj depozite kanë qenë të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Delvinë në shumën 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë, të cilën e kam shitur në vitin 2004 dhe blerësi m'i ka dhënë me vonesë lekët, me sa mbaj mend në vitin 2011 ose 2012, për shkak të vështirësive ekonomike*”.

Lidhur me shtëpinë në Delvinë deklaruar si një nga burimet e krijimit të kësaj depozite

62. Banesë me sip. truall 474 m² e përbërë nga 4 dhoma, korridor, tualet, verandë. Vlera e ndërtimit në shumën 2.500 lekë e ndërtuar me lejen e ndërtimit dhënë në datën 7.6.1988 nga ish-Këshilli Popullor Delvinë. Në deklaratën e vitit 2003 subjekti e ka deklaruar këtë pasuri pa vlerë investimi, me burim krijimi kontribut bashkëshortor.

62.1 Si burim krijimi subjekti ka deklaruar të ardhurat nga puna, me kontribut bashkëshortor, të krijuara para vitit 1990, ndërsa kur i specifikon të ardhurat, subjekti përfshin: të ardhurat të bashkëshortes deri në vitin 1993: të ardhurat e punës, gjatë viteve 1978 – 1981, 1984 në ish-Kooperativën Bujqësore B, fshati M – K; më 26.1.1986 në ish-Ndërmarrjen Bujqësore S; gjatë periudhës 26.1.1986 – 15.2.1992, në ish-NTAN Sarandë; si dhe të ardhurat e bashkëshortes K.A nga punësimi në ish-Ndërmarrjen Ushqimore Sarandë (sektori Delvinë), për periudhën 1.9.1979 – 30.9.1993, si teknologe, sipas vërtetimit të faktit juridik me vendimin nr. **, datë 8.2.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

²⁵ Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura nga punësimi i tij dhe bashkëshortes ndër vite.

62.2 Nga hetimi ka rezultuar se në datën 3.5.2004, subjekti i ka shitur shtetasit B. H pasurinë me kontratën e shitblerjes nr. ***, kundrejt vlerës 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë. Po në datën 3.5.2004 subjekti lidh një aktmarrëveshje me nr. *** rep., me shtetasin B.H, me objekt përcaktimin e modaliteteve të shlyerjes së çmimit.

62.3 Sipas kësaj marrëveshjeje, parashikohet se shuma prej 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekësh është paguar në datën e lidhjes së saj, ndërsa pjesa tjetër prej 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekësh do të likuidohet brenda datës 8.8.2004.

62.4 Të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Delvinë rezultojnë se janë përfituar nga subjekti brenda vitit 2004, bazuar në parashikimet e aktmarrëveshjes me nr. ** rep., datë 3.5.2004, deklarimit të subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 dhe mandatarkëtimit nr.***, datë 20.5.2004, paraqitur nga subjekti, për pagimin e tatimit mbi shumën paraqitur me pyetësorin e datës 3.7.2019.

62.5 Në DPV-në e vitit 2004 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Shtëpinë e banimit në Delvinë e kam shitur te shtetasi B.H me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 2.700.000 lekë, në datën 3.5.2004, me pjesë takuese 50 %*”.

62.6 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të konfirmojë mënyrën e përfitimit të të ardhurave, si dhe të provojë nëse në kohën e përfitimit të tyre është paguar tatimi, në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

62.7 Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit të datës 3.7.2019, ka sqaruar: “*Pagesa në shumën 2.700.000 lekë është dhënë nga shtetasi B. H me lekë cash në dorë. Tatimi për kontratën e shitjes është paguar në shumën 27.000 lekë, me mandatarkëtimin nr. ***, datë 20.5.2004, fakt i provuar dhe nga shkresa me nr. **** prot., datë 13.9.2019, të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tiranë*”. Për të provuar pagimin e tatimit, subjekti paraqiti në cilësinë e provës shkresë nr. *** prot., datë 15.7.2019, të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Sarandë.

62.8 Në ZVRPP-në Sarandë, pasuria ndërtesë, është regjistruar në pronësi të blerësit, shtetasit B. H.

62.9 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultatit, ndër të tjera, për sa subjekti ka kryer deklaratime kontradiktore: lidhur me burimet e krijimit të depozitës në shumën 3.000.000 lekë; nga shitja e shtëpisë në Delvinë në shumën 2.700.000 lekë; si dhe nuk kishte deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 shtimin e pasurisë së luajtshme, likuiditete në shumën 2.700.000 lekë nga shitja e shtëpisë në Delvinë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

63. Subjekti, në përgjigjet e tij, shprehet: “*Përderisa, unë subjekti i rivlerësimit, kam deklaruar kontratën e shitblerjes së shtëpisë me palën blerëse B. H, ku vlera e shitjes ka qenë në shumën 2.700.000 lekë e kam përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar këtë shumë.*”

Gjithashtu, subjekti shprehet: “*Lidhur me arsyetimin e dhënë nga ana juaj në pikën 5 të hetimit, ju parashatroj, si më poshtë se të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Delvinë, të cilat janë tatuar konform ligjeve në fuqi si të ardhura të përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatisë, janë të ardhura të ligjshme dhe pavarësisht ndonjë lapsusi pa dashje, ato duhet të përlllogariten si burim i ligjshëm.*”

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

64. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

64.1 Subjekti nuk arriti të provojë apo të shpjegojë se për se nuk e kishte deklaruar si gjendje të likuiditetit *cash* shumën e përfituar nga shitja e banesës në Delvine në deklaratën periodike vjetore 2004, sikurse e kërkon ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

64.2 Trupi gjykues vlerëson se rezultoi e provuar nga faktet e hetimit administrativ dhe parashikimet e kontratës së shitjes së pasurisë se shuma nga shitja e banesës në Delvinë është përfituar në vitin 2004, për sa vetë subjekti nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur si provë, mandatarkëtimin nr. ***, datë 20.5.2004, provoi pagimin e tatimit për vlerën e plotë të shumës përfituar në këtë vit.

64.3 Deklarimi i subjektit në procesverbalin e datës 29.5.2015, të mbajtur para ILDKPKI-së, se të ardhurat nga shitja e banesës në Delvinë në shumën 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë, blerësi ia ka dhënë me vonesë, me sa subjektit i kujtohej (në vitin 2011 ose 2012, për shkak të vështirësive ekonomike), nuk mbështet nga deklaratimet periodike.

64.4 Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2004 referon përfitimin e vlerës së plotë të të ardhurave nga shitja e pasurisë, pra, në këtë deklaratë dhe në deklaratat vijuese, deri në vitin 2012, subjekti nuk ka deklaruar detyrim të mbetur të blerësit të kësaj pasurie, ndaj shitësit Petrit Aliaj.

64.5 Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues duke i dha deklaratës periodike të pasurisë të vitit 2004, vlerën e provës, duke provuar përfitimin e plotë nga subjekti i të ardhurave nga shitja e banesës në Delvinë, në vitin 2004.

64.6 Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se kontrata e shitblerjes nr. ***, dhe aktmarrëveshja me nr. *** rep., me shtetasin B.H, përcaktojnë qartë se pagesa e çmimit 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë, do të kryhej brenda vitit 2004.

64.7 **Referuar nenit 659** të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “*Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike*”.

Nenit 660 të Kodit Civil ku parashikohet se: “*Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi*”.

Nenit 663 të Kodit Civil në të cilin përcaktohen kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: “*Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji*”.

Nenit 690 i Kodit Civil ku parashikohet se: “*Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj*”.

64.8 Trupi gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratat dhe aktet noteriale, mes palëve, apo në deklarimin periodik të subjektit në vitin 2004, për kohën e likuidimit të çmimit, dhe nuk ka asnjë dokument ligjor provues për të ndryshuar modalitetet e pagesave, dakordësuar mes tyre.

65. Trupi gjykues vlerëson se për sa shuma 2.700.000 lekë, nuk është deklaruar gjendje *cash* në fund të vitin 2004, ajo nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pasurinë e luajtshme likuiditete në bono thesari në vitin 2012.

65.1 Në analizë të deklarimit të subjektit në deklarimin periodik vjetor të vitit 2012, ku si burim është deklaruar se shërbyen të ardhurat e mbajtura *cash* në banesë nga ushtrimi i avokatisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore për burimin

e krijimit të pasurisë likuiditet, duke u përpjekur të justifikojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite bankare në vitin 2012, në Bankën e Shqipërisë në vlerën 3.000.000 lekë.

Në lidhje me pasuritë e deklaruar nga personat e lidhur, me subjektin e rivlerësimit

65.2 Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit nga ku ka rezultuar, si vijon:

Personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, znj. K.A, ka deklaruar si vijon:

66. Tokë arë me sip. 712 m², në Y, Tiranë – sip. 300 m² sipas kontratës së shitblerjes nr. ****, datë 25.6.2002, në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** dhe sip. **412 m²**, sipas kontratës së shitblerjes nr. ****, datë 12.8.2002, në vlerën **200.000 (dyqind mijë) lekë**, blerë në shumën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

66.1 Lidhur me këtë pasuri është lidhur kontratë sipërmarrjeje ndërtimi nr. ***, datë 8.4.2010, për ndërtim të një objekti shumëkatësh mbi sipërfaqen e truallit 712 m² me sipërmarrës shoqërinë “A-N” sh.p.k. dhe aneks kontrate nr. ***, datë 1.7.2011.

66.2 Familja Aliaj ka në përdorim * (pesë) apartamente banimi, një dyqan dhe garazhet. Apartamentet e banimit kanë sipërfaqet: 88.1 m², 91.3 m², 100.7 m², 98.1 m² dhe 77.4 m². Dyqani me sip. 94 m² dhe garazh me sip. 100 m².

66.3 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektin iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultatit, ndër të tjera, dhe lidhur me çmimin e blerjes së tokës duket se çmimi i blerjes së pasurive të mësipërme është fiktiv, duke konsideruar se pasuritë janë blerë shumë më shtrenjtë sesa i janë shitur bashkëshortes së subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

67. Subjekti, në përgjigjet e tij, shprehet: *“Në momentin e blerjes së pasurisë tokë arë me sip. 300 m², nuk kam qenë në dijeni se si e kanë përfituar këtë pronë shitësit, shtetasit P. R dhe M.R, pasi nga këta të fundit më është vënë në dispozicion në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes certifikata e pronësisë datë 28.9.1998, kartela e pasurisë së paluajtshme, plani i rievimit dhe vërtetimi i Komunës K, datë 25.6.2002, ku këto prova janë verifikuar nga noteri në momentin e formulimit të kontratës. Në këto kushte, bashkëshortja K. A nuk ka qenë në dijeni për origjinën e pronës. Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.6.2002, ka fuqi të plotë provuese, në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me vërtetësinë e çmimit të shitjes, të përcaktuar me vullnetin e lirë të palëve në kontratë dhe të konfirmuar nga nëpunësi publik.*

*Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 12.8.2002, është akt zyrtar me fuqi të plotë provuese, në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile dhe është përfituar nga shtetasit N dhe L.A, të cilët kanë qenë përftues nga ligji nr. 7501/1991, ‘Për tokën’. Në momentin e lidhjes së kontratave, tokat arë kanë qenë në gjendje kënete dhe ferra dhe duke iu referuar dhe çmimeve sipas akteve ligjore në fuqi, ato rezultojnë në përputhje me to. Fiktiviteti i një kushti kontraktor përbën shkak për kundërshtimin e kontratës nga palët që kanë lidhur kontratën, jo nga subjekte të tretë të cilët nuk janë palë. Çmimi i sendit në rastin konkret është vendosur nga palët lirisht, duke pasur parasysh gjendjen e sendit në kohën e lidhjes së kontratës. Arsyetime dhe opinione të subjekteve të tretë që nuk janë palë në këtë kontratë nuk shtrijnë efektet mbi vullnetin e palëve kontraktore dhe nuk e cenojnë atë.”*

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

68. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në referim të vendimit nr. 10, datë 18.4.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (pika 44.1), arsyeton se:

68.1 Në Kodin Civil (neni 690) parashikohet se kontrata ka fuqinë e ligjit për palët që e nënshkruajnë dhe, në rastin konkret, ka pasur një efekt të tillë për palët (shitës-blerës), pasi nuk kanë asnjë pretendim dhe është një kontratë që është ekzekutuar, për sa u përket të drejtave dhe detyrimeve që janë parashikuar në të, por kjo nuk do të thotë që ka fuqinë e ligjit dhe është e padiskutueshme edhe për të tjerët, të cilët nuk janë palë në kontratë. Kjo nuk do të thotë se çmimet e parashikuara nga palët janë reale, pasi është një fakt i njohur që çmimet e shitblerjeve në kontrata janë vendosur me marrëveshje të palëve, dhe jo gjithmonë përfaqësojnë çmimin real.

68.2 Nga analiza e çmimit të shitblerjes së pasurive së paluajtshme, objekt i marrëdhënies juridike, trupi gjykues, referuar çmimit **50 mijë lek për sip. 300 m²**, në vitin 2002, pavarësisht vullnetit të palëve në një marrëdhënie kontraktore, ky çmim duket i sforcuar, dhe shumë larg vlerës reale të tregut, ka dyshime të arsyeshme se çmimi i blerjes së pasurisë së paluajtshme nga subjekti i rivlerësimit është fiktiv.

68.3 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me çmimin e blerjes prej 250.000 lekësh në total për sipërfaqen 712 m².

69. **Depozitë në shumën 2.000.000 (dy milionë) lekë, datë 18.3.2013**, në Bankën e Shqipërisë, dega Gjirokastrë. Burimi i krijimit: punësimi i shtetases K.A në subjektin “E” sh.p.k., Sarandë, gjatë periudhës 2010 – 2012.

69.1 Një pjesë e vogël prej 240.000 (dyqind e dyzet mijë) lekësh e ka burimin nga shuma të cilën e ka pasur *cash* në shtëpi, të tërhequr nga shuma e përgjithshme prej 900.000 (nëntëqind mijë) lekësh, nga mbyllja e depozitës bankare rreth viteve 2002 – 2003, në emër të bashkëshortes K.A, në Bankën e Kursimeve të shtetit. Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

69.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2019, Banka e Shqipërisë konfirmon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka çelur depozitë në bono thesari në shumën 2.000.000 (dy milionë) lekë, në datën 26.3.2013, me afat njëvjeçar, të cilën e ka riinvestuar edhe për një vit tjetër në datën 25.3.2014.

69.3 Burimet e krijimit të kësaj depozite janë deklaruar nga të ardhurat e punësimit të bashkëshortes së subjektit, znj. K.A, në shoqërinë “E” sh.p.k., Sarandë.

69.4 Nga hetimi i Komisionit²⁶ ka rezultuar se **janë deklaruar të ardhura *neto* në total, në shumën 69.184 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekë, nga punësimi i bashkëshortes së subjektit në shoqërinë “E” sh.p.k., vetëm për vitin 2012**, për muajt mars, prill, maj, tetor dhe nëntor.

69.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultatit se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për të investuar në bono thesari.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me arsyetimin e dhene nga ana juaj se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë nga bashkëshortja e tij dhe se personat e lidhur

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2019, e ISSH-së dhe shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2017. e ISSH-së në dosjen e ILDKPKI-së.

me të nuk kanë pasur mundësi financiare për të investuar në bono thesari, duke rezultuar me një balancë negative në shumën 2,214,289 lekë, po iu parashtroj si me poshte:

Ne fq.** te vendimit gjyqesor te formes se prere nr. **(***) dt.04.07.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan, kjo e fundit rezulton te kete arsyetuar ne lidhje me kete pike se: Nga të dhënat e analizuara në tërësi rezulton dhe konstatohet se DRSSH Sarandë me shkresë ë. *** datë 09.09.2015 ka informuar rreth faktit të ekzistencës së punësimit të shtetases K.A, pra nuk konfirmohet pretendimi i kallzuesit sipas të cilit nga subjekti nuk argumentohet punësimi i bashkëshortes, fakti përforcohet nga pohimet dhe dëshmia e shtetases E.Sh, administratori i shoqërisë E sh.p.k dhe duke analizuar te ardhurat e perfituara nga shtetesia K. A nuk rezultojne te ardhura te perfituara me teper nga kjo shtetase apo te ardhura te shtuara te dyshimta.....Arsyetimi i dhene nga ana juaj se kam rezultuar ne nje balance negative në shumën — 2,214,289 leke eshte ne kundërshtim me bilancin e rezultuar nga akti I ekspertimit kontabel I cituar ne pjesen pershkruese te arsyetimit te vendimit gjyqesor te formes se prere nr. **(***), dt.04.07.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan (shih fq. **-* te vendimit).

Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij nga shoqëria E, subjekti ka shpjeguar vertetimet date 05.01.2017 dhe 04.07.2015 te shoqerise E. shpk dhe librezat e punes jane akte zyrtare me fuqi te plote provuese ne kuptim te nenit 253 te K.Pr.C.

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

69.6 Me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të bashkëshortes së subjektit, me burim të ardhurat nga punësimi i saj, Komisioni vlerësoi dokumentacionin e paraqitur prej subjektit²⁷ për të provuar të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes.

69.7 Bazuar pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat për të cilat janë paguar tatimet, ndërkohë që në rastin konkret subjekti nuk arriti të provojë të ardhurat e ligjshme të bashkëshortes, pasi nuk arriti të depozitonte dokumentacion ligjor provues për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore për vitet për të cilat janë deklaruar prej tij të ardhura nga bashkëshortja për krijimin e kësaj depozite.

69.8 Duke marrë në konsideratë faktin se për bashkëshorten kanë rezultuar se për vitet 2010-2012 janë deklaruar të ardhura *neto* në total, në shumën **69.184 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekë, nga punësimi në shoqërinë “E” sh.p.k., vetëm për vitin 2012**, ato janë të papërfillshme referuar vlerës së investimit të saj ne likuiditete.

69.9 Për periudhën 2010 – 2011 nuk provohet punësimi i bashkëshortes së subjektit. Vërtetimi nga shoqëria “E” sh.p.k., dhe librezat e punës nuk provojnë përfitimin e të ardhurave, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

69.10 Nga hetimi i Komisionit²⁸ të ardhurat e bashkëshortes nuk përputhen pagat e pretenduara me pagat e deklaruar në organin kompetent, për vitet 2012 – 2014.

69.11 Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk u arrit të provohet burimi i ligjshëm i krijimit të depozitës për sa kohë që për të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes në vitet 2010, 2011 dhe 2012, nuk provohet pagimi i detyrimeve tatimore në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Person i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit, L.A, ka deklaruar si vijon:

70. Automjet tip “MNV P, M”, blerë me kontratën nr. *, datë 26.10.2009, regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Sarandë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga**

²⁷ Dosje e ILDKPKI-së, aneksi **: vendim gjykate nr. **, datë 8.2.2008.

²⁸ Shkresë *** prot., datë 19.2.2019, e ISSH-së.

puna e kryer gjatë pushimeve verore në vitet 2008 – 2009, në Greqi, te shtetasi A.Dh. M. Vlera: 7.000 (shtatë mijë) euro. Pjesa takuese: 100 %.

70.1 Për të provuar të ardhurat në shumën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro nga puna e kryer gjatë pushimeve verore, në vitet 2008 – 2009, në Greqi, subjekti ka paraqitur para ILDKPKI-së aktdeklaratën me përgjegjësi të shtetasit A. M, me vërtetim-përkthimi nr. ***, datë 6.12.2015.

70.2 Lidhur me të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga djali i subjektit, nga punësimi në Greqi për vitet 2008 – 2009, Komisioni kreu disa verifikime:

70.2.1 Nga verifikimi në sistemin e lëvizjeve të hyrje-daljeve të djalit të subjektit, rezultoi: se për vitin 2008, ka vetëm një dalje nga kufiri shqiptaro-grek, datë 4.7.2008, pa datë kthimi; në datën 21.12.2008 ka udhëtuar në drejtim të Italisë nga pika kufitare e Rinasit; ndërsa për vitin 2009 ka dalje nga kufiri shqiptaro-grek në datën 13.3.2009 dhe kthimin më 23.3.2009; ka dalë sërish në datën 23.6.2009 dhe është kthyer më 13.7.2009, lëvizje të provuara vetëm për pak ditë.

70.2.2 Komisioni administroi aktdeklaratën me përgjegjësi të shtetasit A.M, e përkthyer me vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 6.12.2015, pra, në këtë akt shtetasi A.M ka deklaruar se z. L.A ka punuar për llogari të tij për dy vjet, me shpërblim total në vlerën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro. Shlyerja e plotë e detyrimit është bërë në vitin 2009.

70.3 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultatit, ndër të tjera, për sa ka rezultuar se ka mungesë dokumentacioni ligjor për të provuar të ardhurat e ligjshme të djalit të subjektit në vitet 2008 – 2009, në shumën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro, si burim për blerjen e automjetit “MN V P. M” dhe se nuk provohet udhëtimi apo qëndrimi i djalit të subjektit në shtetin grek, për periudhën 2008 – 2009.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

71. Subjekti, në përgjigjet e tij, shprehet: *“Me përfundimin e vitit shkollor 2007-2008, djali L.A ka shkuar si emigrant në Greqi në datën 4.7.2008 dhe aty ka qëndruar i punësuar gjatë pushimeve verore duke u kthyer në Shqipëri në muajin shtator të vitit 2008 me fillimin e sezonit të ri shkollor. Nuk është përgjegjësia jonë që autoritetet kufitare shqiptare nuk iu kanë dhënë informacionin e duhur për datën e kthimit të djalit L. A. Përderisa, djali L.A ka shkuar në Greqi përmes pikës kufitare, kthimi i tij në territorin shqiptar është bërë përmes pikës kufitare dhe sikundër e s’përmendem, është kthyer në Shqipëri me fillimin e sezonit të ri shkollor 2008 – 2009.*

Në vitin 2009, përveç datave të cituara nga ana juaj, djali L. A ka dalë nga territori shqiptar në fund të Korrik të vitit 2009 dhe është kthyer në shtator të viti 2009 me fillimin e vitit të ri shkollor. Nuk është përgjegjësia e jona se periudha e daljes nga territori shqiptar në fund të korrik 2009 nuk figuron në sistemin Tims dhe, po ashtu, hyrja në shtator të vitit 2009.

Lidhur me arsyetimin e dhënë nga ana juaj se deklarata e shtetasit A.M, datë 6.12.2015, nuk provon deklarin e të ardhurave nga punësimi në organin kompetent të shtetit grek për djalin e subjektit, si dhe pagimin e tatimeve...ju parashtroj si vijon: Përderisa, punëdhënësi A.M ka deklaruar se shlyerja e plotë e detyrimit u bë në vitin 2009 dhe se L. A ka punuar për llogari të tij për dy vjet, vërteton faktin se L.A është paguar në përfundim të marrëdhënieve të punës me punëdhënësin në vitin 2009 dhe me konkretisht në shtator 2009. Shtetasi A.M ka konfirmuar marrëdhëniet e punës gjatë dy vjetëve e cila përkon me periudhën e pushimeve verore të vitit 2008 dhe 2009. Detyrimet e punëmarrësit në shtetin grek shlyheshin nga punëdhënësi dhe përderisa ky i fundit e ka lëshuar deklaratën me përgjegjësi të plotë para autoriteteve policore greke konfirmon përmbushjen e detyrimeve si punëdhënësi në shtetin grek.”

71.1 Në datën 2.6.2020, me anë të postën elektronike, subjekti paraqiti kërkesë për kohë për të paraqitur dokumentacionin që lidhet me punësimin e djalit L. A, në Greqi.

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

72. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në referim të vendimit nr. 10, datë 18.4.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (pika 44.1), arsyeton se:

72.1 Lidhur me kërkesën e subjektit për dhënie kohë shtesë për paraqitjen e dokumentacionit që lidhet me punësimin e djalit L.A, në Greqi, referuar proceverbalit të mbledhjes së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë zhvilluar më 10 shkurt 2017, bërë publik në median si vijon <https://dritare.net/akuzat-per-pasurine-rrerefet-gjyqtari-aliaj-ju-tregoj-si-i-bera-vilat> pyetur për të ardhurat e djalit të tij në shtetin grek subjekti ka deklaruar se *“Djali im L. A ka shkuar çdo verë për vite me radhë tek kushërinjtë e tij të parë në shtetin Grek, të cilët janë emigrantë ekonomikë në Greqi, duke punuar dhe ai si emigrant ekonomik. Djali im ka punuar në detyrën e “bodyguard” nëpër kazino nate, pa patur leje punësimi si të shumica e emigrantëve të tjerë ekonomikë shqiptarë, në punë të zeza, duke rrezikuar edhe jetën“.*

72.2 Lidhur me kërkesën për dhënie kohë shtesë për paraqitjen e dokumentacionit që lidheshin me punësimin e djalit L.A, në Greqi, në referim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ky informacion është i panevojshëm, bazuar në nenin 49/6/a të ligjit nr. 84/2016.

72.3 Trupi gjykues vlerëson se subjekti pavarësisht se referuar deklaratimit të mësipërm të tij para KLD ishte i vetëdijshëm se nuk mund të sigurojë dokumentacion shtesë për djalin e tij për punësimin në Greqi, ka bërë kërkesë për kohë shtesë në lidhje me këtë dokumentacion, duke u përpjekur të shtyjë seancën dëgjimore dhe të ndikojë në vonesën e procesit të tij të rivlerësimit.

72.4 Komisioni vlerësoi dokumentacionin e paraqitur prej subjektit për të provuar të ardhurat nga punësimi i djalit në Greqi, deklaratën noteriale të shtetasit A.M, datë 6.12.2015. Deklarata e shtetasit, A.M, nuk provon deklarin e të ardhurave nga punësimi në organin kompetent të shtetit grek për djalin e subjektit, si dhe pagimin e tatimeve, në kuptim të pikës 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

72.5 Bazuar pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të ardhura të ligjshme për qëllimet e këtij ligji, konsiderohen të ardhurat për të cilat janë paguar tatimet, ndërkohë që në rastin konkret subjekti nuk arriti të depozitojë dokumentacion ligjor provues për të provuar periudhën e punësimit të djalit në Greqi, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e mundshme të përfituara dhe të përdorura si burim krijimi.

72.6 Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk u arrit të provohet burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë së luajtshme, automjet nga djali i subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që për të ardhurat nga punësimi i tij nuk provohet pagimi i detyrimeve tatimore në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Fakte të tjera nga hetimi administrativ

73. Nga analizimi i dokumentacionit bankar ka rezultuar një derdhje në llogari të djalit të subjektit, L.A, nga shtetasi A.G, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) USD, datë 27.11.2008 dhe tërheqje e kësaj shume në datën 2.12.2008 në “Alpha Bank”²⁹. Lidhur me këtë transaksion, shtetasi A.G ka lëshuar deklaratën noteriale nr. **, datë 16.1.2017, sipas së cilës konfirmon depozitim në llogari të djalit të subjektit, L.A, shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) USD e cila është shlyer në datën 2.12.2008 (dhënë dorazi).

²⁹ Referojuni dokumentacionit të ILDKPKI-së, Aneksi ***.

73.1 Lidhur me këtë shumë, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues në zbatim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

73.2 Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion provues ligjor mbi të ardhurat e shtetasit A.G.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

74. Subjekti, në përgjigjet e tij, shprehet: *“Lidhur me arsyetimin e dhënë nga ana juaj se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues në zbatim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 për shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) USD, të marrë hua nga shtetasi L.A, po iu parashtroj, si më poshtë:*

Shtetasi L. A, në datën 31 dhjetor të vitit 2008 nuk ka pasur asnjë detyrim ndaj shtetasit A.G, pasi huaja është kthyer brenda një afati shumë të shkurtër, 10-ditor, dhe nuk është mbartur si detyrim për vitin tjetër.

Nuk ka ekzistuar marrëdhënia e huas në fund të vitit kalendarik dhe në deklaratën periodike vjetore ishte detyrim ligjor të deklaroje huan dhe burimin e të ardhurave të huas nëse ky detyrim ekzistonte deri në datën 31 dhjetor të çdo viti. Përveç kësaj, sqarojmë faktin se shtetasi A.G ka qenë administrator i shoqërisë ‘A’ sh.a. në periudhën në fjalë dhe është i njohur në publik si biznesmen korrekt në marrëdhëniet e detyrimeve tatimore me shtetin.”

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

75. Trupi gjykues, në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se personat që kanë pasur lidhje interesi që rrjedh nga një interes pasuror me subjektin e rivlerësimit dhe, personat e lidhur me të duhet të marrin cilësinë e personit tjetër të lidhur, duke u kaluar detyrimin për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave, dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

75.1 Shpjegimi i subjektit se personi i lidhur, shtetasi L. A, në datën 31.12.2008, nuk ka pasur asnjë detyrim të deklarojë huan dhe burimin e të ardhurave të huas nëse ky detyrim nuk ekzistonte deri në këtë datë, nuk është në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

75.2 Pretendimi i subjektit se kjo vlerë është kthyer brenda vitit 2008 nuk provohet nga asnjë dokumentacion ligjor provues dhe deklarata e nënshkruar nga shtetasi A. G vetëm në vitin 2017, pra, 9 vjet pas kryerjes se veprimit, në kohën e miratimit të ligjit nr. 84/2016, për këtë arsye ka vlerë të kufizuar provuese.

75.3 Sipas nenit 4 të ligjimit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar “Afati dhe objekti i deklarimit”, parashikon se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj.”*

75.4 Trupi gjykues, duke pasur parasysh standardin kushtetues e ligjor që përcaktojnë dispozitat e posaçme mbi kontrollin e pasurisë, si dhe faktin se kjo shumë nuk është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008 dhe as në deklaratën *Vetting*, dhe nuk provohet destinacioni i saj.

75.5 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte shumën, e kaluar në llogarinë bankare të personit të lidhur me të, nga një person i tretë bazuar në parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 3, pika 11, 30-32 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

75.1 Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

76. Komisioni, lidhur me personat e lidhur/vajzat e subjektit të rivlerësimit, R dhe M.A, analizoi shpenzimet e shkollimit të tyre sipas deklaramit në Vetting, si vijon:

76.1 Shpenzimet e shkollimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës(në vijim SHBA) të vajzës së subjektit, znj.R.A, janë deklaruar se janë paguar dorazi nga xhaxhai i tij, por nuk provohen me dokumentacion ligjor provues.

76.2 Shpenzimet e shkollimit në SHBA të vajzës së subjektit M.A janë deklaruar se janë paguar nga dhurime dhe huat e marra, si vijon:

(i)Në vitin 2016, dhurim në shumën 14.000 (katërbëdhjetë mijë) USD nga shtetasi A.B.Xh, provuar me deklaratë noteriale nr. *****, datë 10.9.2016 dhe me deklaratën datë 10.12.2016 të shtetasve A dhe M. Xh.

Burim i kësaj shume është deklaruar nga subjekti si e përfituar: pjesërisht shuma 7.000 (shtatë mijë) USD nga kursimet e pensionit të pleqërisë që shtetasi A. Xh tërheq në Shqipëri; dhe pjesa tjetër në shumën 7.000 (shtatë mijë) USD e ka burimin nga dhurata që shtetasi A.Xh e ka nga djali i tij M. Xh, i cili e ka siguruar këtë shumë nga punësimi i tij në SHBA, gjatë vitit 2015.

(ii)Në vitin 2016 hua pa afat, nga shtetasi N dhe M.P, në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, provuar me deklaratë noteriale nr. *****, datë 9.5.2016.

Sipas deklaramit të vajzës së subjektit, kjo shumë e ka burimin nga aktiviteti i ligjshëm i biznesit “Bar-Bufe”, me NIPT K*****A, që shtetasja M.P (bashkëshortja e shtetasi N. P), ka ushtruar në fshatin Gjashtë, Sarandë, në vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015, ku për këto të ardhura është paguar tatimi mbi të ardhurat, sipas ligjeve në fuqi.

76.3 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa vijon:

-Mosdeklarim nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 dhe në vijim, për shpenzimet e shkollimit dhe të qëndrimit dhe të mungesës së burimeve të ligjshme financiare për shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit, znj. R.A, në SHBA.

-Mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit, znj. M.A, në SHBA për sa nuk provohen të ardhurat e ligjshme të z. M.Xh, në SHBA, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nuk provohet të jetë tërhequr pensioni i pleqërisë së shtetasi A.Xh, dhe për sa nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të shumave të dhëna hua nga shtetasi P.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

77. Subjekti, lidhur me shpenzimet për vajzën R.A, parashtroi si vijon: *“Shpenzimet e shkollimit të vajzës R.A në SHBA gjatë periudhës së studimeve i kemi deklaruar në deklaratën Vetting. Shpenzimet e studimeve janë paguar nga të ardhurat e punësimit të vajzës R. A në SHBA, si dhe me ndihmën prej xhaxhait të babait, z. S. A, ku ky i fundit ka kontribuar edhe për shpenzimet e qëndrimit. Kjo ndihmë i është dhënë dorazi, gjatë vizitës në New York. Gjithashtu, pjesë të shpenzimeve të qëndrimit dhe të studimeve janë mbuluar nga R.A me anë të të ardhurave personale gjatë kohës që ka studiuar dhe ka mbajtur pozicione të ndryshme, të përshkruara në deklaratën Vetting.*

R.A është në pamundësi për të paraqitur dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e të ndjerit S.A për shkak të vdekjes së tij në vitin 2009 dhe se në rastin konkret, duke vlerësuar në tërësi të

gjitha rrethanat e çështjes dhe pamundësisë nga ana ime për të paraqitur dokumentacionin për të ardhurat e ligjshme të xhaxhait tim, duhet zbatuar neni 32/2 1 ligjit nr. 84/2016 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë' në të cilin parashikohet shprehimisht: 'Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

Subjekti lidhur me shpenzimet per vajzën M.A, parashtrori, si vijon: “*Sikundër kam deklaruar edhe në deklaratën Vetting dhe deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, shpenzimet e shkollimit për M.A janë siguruar nga huaja e marrë në vitin 2016 nga shtetasit N dhe M.P, provuar me deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.5.2016, ku këto të ardhura janë siguruar nga aktiviteti privat i këtyre shtetasve. Lidhur me të ardhurat e ligjshme të këtyre shtetasve, iu kemi paraqitur në cilësinë e provës shkresore shkresën kthim përgjigje **** prot., datë 24.10.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, në të cilën pasqyrohen të ardhurat e këtyre shtetasve gjatë viteve 2009 – 2015, si dhe shkresën kthim-përgjigje nr. **** prot., datë 24.10.2016, të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë.*

*Gjithashtu, M. A ka përfituar dhurim në shumën 14.000 (katërbëdhjetë mijë) USD nga shtetasi A.B.Xh, provuar me deklaratë noteriale nr. ****, datë 10.9.2016 dhe me deklaratën datë 10.12.2016 të shtetasve A dhe M. Xh.*

*Burimi i kësaj shume është pjesërisht shuma 7.000 (shtatë mijë) USD nga kursimet e pensionit të pleqërisë që shtetasi A.Xh tërheq në Shqipëri (vërtetimi nr. ****prot., datë 17.10.2016, e Degës së Sigurimeve Shoqërore Sarandë, datë 6.1.2003, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë, dega Delvinë, bashkëlidhur vendimit për caktim pensioni, datë 12.2.2003) dhe pjesa tjetër në shumën 7.000 (shtatë mijë) USD e ka burimin nga dhurata që shtetasi A. Xh e ka nga djali i tij M. Xh. Shtetasi M. Xh e ka siguruar këtë shumë nga punësimi i tij në SHBA gjatë vitit 2015, fakt që rezulton nga shkresa datë 5.12.2016.”*

77.1 Subjekti ka paraqitur të njëjtat dokumente³⁰ të paraqitura gjatë hetimit administrativ, por pas kalimit të barrës së provës i depozitoi në formën e kërkuar ligjore, për të provuar burimet e financimit të shkollimit të vajzës M. A.

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

78. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ arsyetohet se:

Lidhur me shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit, znj.R.A

78.1 Subjekti nuk arriti të provojë sa ka deklaruar se shpenzimet e shkollimit në SHBA janë paguar dorazi nga xhaxhai i subjektit.

³⁰ Shkresë kthim-përgjigje nr. **** prot., datë 18.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, drejtuar shtetasit M.P, bashkëlidhur deklaratat tatimore për këtë periudhë kohore, si dhe shkresa kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 24.10.2016, e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore; deklaratë noteriale nr. ****, datë 10.9.2016 e shtetasit A.B. Xh dhe deklaratë datë 10.12.2016 të shtetasve A dhe M.Xh; vërtetimi nr. *** prot., datë 17.10.2016, e Degës së Sigurimeve Shoqërore Sarandë, datë 6.1.2003, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë.

78.2 Lidhur me deklarinimin mbi pamundësinë objektive për të paraqitur provë shkresore nga xhaxhai S.A, për të provuar të ardhurat dhe burimin e tyre për shkak të vdekjes së tij në vitin 2009, Komisioni vlerëson se subjekti nuk është në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e të ardhurave të xhaxhait me arsyetimin e vdekjes së tij, në kuptim të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

78.3 Në rastin konkret, vdekja e xhaxhait të subjektit të rivlerësimit nuk lidhet dhe as nuk kushtëzon provueshmërinë e të ardhurave të ligjshme të deklaruara rregullisht në institucionet kompetente të vendit, ku janë përfituar të ardhurat nga xhaxhai i subjektit dhe për të cilat janë paguar tatimet, në kohën e kryerjes së dhurimit.

Lidhur me shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit, znj. M.A

78.4 Lidhur me shpenzimet e shkollimit të vajzës M.A, referuar deklarinimit periodik të vajzës së subjektit në vitin 2016 pagesat e shkollës janë bërë në muajt korrik - gusht të vitit 2016.

78.5 Sipas deklarinimit noterial të shtetasit A.Xh dhënia e shumës 14.000 USD është bërë në shtator të vitit 2016. Në këto kushte nuk provohet se kjo hua ka shërbyer për pagesat e universiteteve nëpërmjet transfertave bankare.

78.6 Referuar të dhënave nuk rezulton që subjekti të këtë arritur të provojë transferimin e këtyre shumave në SHBA nëpërmjet rrugës bankare apo tokësore, për sa në daljen e saj në janarin e vitit 2017 vajza e subjektit nuk deklaruar në kufi, transportimin e vlerës prej 14.000 USD, e cila ishte mbi vlerën e detyrueshme për deklarim gjatë daljes nga aeroporti i Rinasit, për të provuar destinacionin e vlerave monetare dhe mbërritjen e tyre në SHBA.

78.7 Trupi gjykues e gjen të paarsyeshëm edhe shpjegimin e dhënë nga subjekti edhe rrjedhën e ngjarjeve, sipas të cilave vlerat monetare të fituara në SHBA u transportuan në Shqipëri për t'ju dhuruar vajzës së subjektit, e cila do të duhej t'i transportonte këto vlera përsëri në SHBA për t'i përdorur gjatë shkollimit. Nëse individët, shtetas amerikane, me banim në SHBA kishin vendosur të ndihmonin vajzën e subjektit për shpenzimet e shkollimit të saj, mund ta bënin duke mundësuar këtë sasi të hollash në SHBA, në vendin ku ata banonin dhe ku do të shkollohej edhe vajza e subjektit, pa kryer transaksionet vajtje-ardhje të vlerave të konsiderueshme monetare të cilat ngrenë dyshime mbi vetë vlefshmërinë e transaksioneve.

78.8 Lidhur me shpenzimet e shkollimit të vajzës M. A, përballuar me huan e marrë nga shtetasit N dhe M.P, në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, provuar me deklaratë noteriale nr. *****, datë 9.5.2016.

78.9 Nga vlerësimi i dokumentacionit, lidhur me mundësitë financiare të këtyre dy shtetasve të buruara nga aktiviteti tregtar, rezultoi se të ardhurat e personave të tjerë të lidhur (referuar legjislacionit të kohës së përfitimit të të ardhurave si Person Fizik, të shtetasës M. P nga viti 2007) nga aktiviteti ishin në vlerën **prej 5.980.610** lekësh.

78.10 Fitimit *neto* nga aktiviteti tregtar, është përlogaritur mbi të ardhurat nga aktiviteti për të cilin janë paguar detyrimet tatimore përkatëse të konfirmuara nga organet tatimore, përkatësisht nga Taksat Vendore të Bashkisë me shkresën nr. ***** prot., datë 24.10.2016, dhe me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2016, lëshuar nga DRT-ja Sarandë.

78.11 Për sa i përket të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti tregtar i këtyre shtetasve në vitin 2006, nuk rezulton se subjekti M.P të ketë paguar detyrimin e taksës vendore mbi biznesin e vogël për këtë vit ushtrimor të aktivitetit.

78.12 Nga analiza, duke mos marrë në konsideratë investimet që mund të jenë kryer nga personat e tjetër të lidhur, rezulton se shuma e fitimit *neto* është më e ulët se shpenzimet jetike për familjen

e personave të tjetër të lidhur (huadhënësve) të cilat për këtë periudhë rezultojnë në vlerën **7.047.110 lekë** (referuar regjistrin të gjendjes civile familja P rezulton me 5 anëtarë).

78.13 Për rrjedhojë, Komisioni çmon se personat e tjerë të lidhur/ N dhe M.P, nuk kanë pasur mjete financiare të ligjshme që mund të shërbenin për huan në vitin 2016.

Fakte të tjera nga hetimi administrativ

79. Gjatë hetimit konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007.

66.23 Konkretisht, në vitin 2004 nga subjekti është çelur llogari bankare nr. ***** EA, në euro, “Tirana Bank”, ku janë kryer këto transaksione:

- në datën 10.6.2004, depozitim *cash*, shuma 29.650 (njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, tërhequr në datën 15.7.2004, shuma 29.688 (njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) euro;
- në datën 18.7.2005 është depozituar *cash* shuma 20.000 (njëzet mijë) euro, duke i vendosur depozitë me afat, e cila është transferuar nga llogaria e kursimit dhe në datën 22.8.2005 është tërhequr *cash* shuma 19.500 (nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro;
- në datën 28.7.2006 është depozituar *cash* shuma prej 19.500 (nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro, e cila është vendosur në depozitë me afat dhe është tërhequr në datën 4.9.2006, shuma 19.200 (nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind) euro;
- në datën 25.7.2007 është depozituar *cash* shuma 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro dhe këtë shumë e ka tërhequr në datën 27.8.200

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

80. Subjekti, në përgjigjet e tij, shprehet: *“Në deklaratimet e datës 23.11.2009, kam dhënë shpjegime në lidhje me shumën e marra hua nga shtetasi O.L duke sqaruar se i janë marrë shtetasit O.L në valutën euro të konvertuar në dollarë si **garanci për nxjerrje vize për në SHBA për vajzën R. A** dhe shumën e marra hua i janë rikthyer përsëri shtetasit O. L rreth një muaj e disa ditë nga dita e marrjes.*

Në këto kushte, shtetasi Petrit Aliaj në datën 31 dhjetor të çdo viti kalendarik nuk ka pasur asnjë detyrim ndaj shtetasit O.L, pasi sikundër u shprehem huat janë kthyer brenda një afati shumë të shkurtër dhe nuk mbarteshin si detyrim për vitin tjetër. Nuk ka ekzistuar marrëdhënia e huas në fund të vitit kalendarik dhe në deklaratën periodike vjetore ishte detyrim ligjor të deklaroje huan dhe burimin e të ardhurave të huas nëse ky detyrim ekzistonte deri në datën 31 dhjetor të çdo viti.”

Analiza e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

81. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar “Afati dhe objekti i deklaratimit”, parashikon se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj.”*

81.1 Shpjegimi i subjektit **lidhur me shumën e depozituar prej tij, nuk ishte bindës dhe** nuk ishte i shoqëruar me asnjë provë ligjore për të provuar se ato shumën janë marrë hua apo se ka pasur aplikimin të përvitshëm për marrje vize nga vajza e tij në vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007.

81.2 Këto transaksione nuk janë deklaruar as si depozitime në bankë si dhe as si hua sikundër është pretenduar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2004, 2005, 2006 dhe 2007, vite në të cilat janë kryer depozitimet në llogaritë bankare të subjektit dhe as në deklaratën *Vetting*.

81.3 Trupi gjykues, duke pasur parasysh standardin kushtetues dhe ligjor që përcaktojnë dispozitat e posaçme mbi kontrollin e pasurisë dhe faktin se këto depozitime nuk janë deklaruar në deklaratat periodike përkatëse dhe as në deklaratën *Vetting*, arrin në konkluzionin se nuk provohet marrja e këtyre të ardhurave nga shtetasi O.L, sikundër pretenduar nga subjekti. nuk provohet destinacioni i tyre, apo kthimi i tyre, shtetasit O.L.

81.4.Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti rivlerësimi kishte detyrimin të deklaronte shumat, e kaluara në llogarinë bankare të tij, edhe nëse ato ishin përfituar nga një person i tretë, bazuar në parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 3, pika 11, 30-32 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

81.5 Për sa i përket shpjegimeve dhe provave të subjektit për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të shtetasit O.L referuar dokumentacionit të sjellë në cilësinë e provës, vërtetimin e lëshuar nga Zyra Vendore Arsimore Sarandë, për të provuar punësimin e bashkëshortes së shtetasit O.L, znj. L.L, si arsimtare, të ardhurat e referuara në këtë provë janë të pakonsiderueshme në krahasim me shumat e depozituara në llogarite e subjektit dhe, në asnjë rast, nuk mund të mbulojnë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre shumave.

81.6 Për sa i përket shpjegimeve dhe provave të subjektit për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të shtetasit O.L, dokumentacioni i depozituar, printime nga llogaria bankare e shtetasit O.L, për periudhën 2004 – 2005, nuk provon mundësinë e tij për krijimin e shumave të ligjshme, për sa nuk provohet pagesa e tatimeve për këto shuma.

81.7 Trupi gjykues vlerëson se pasja e një llogarie bankare nuk ligjëron dhe justifikon burimin e saj dhe se dokumentacioni bankar nuk provon mundësinë për krijimin e shumave të ligjshme, për sa nuk provohet pagesa e tatimeve.

81.8 Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm, në lidhje me këto transaksione, për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

82. Në përfundim të analizës së kryer, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e shkollimit të vajzave R dhe M.A, pasi nuk ka provuar burimet e ligjshme të shpenzimeve të shkollimit të tyre në SHBA.

DENONCIMET

83. Nga administrimi i denoncimeve të ardhura në Komision (denoncim nr. ***, datë 18.12.2017; denoncim nr. ***, datë 30.7.2018, i shtetasës B. S; denoncim nr. *** prot., datë 5.4.2018, i shtetasit K.M.N) janë raportuar të dhëna për pasuri të fshehura nga subjekti i rivlerësimit, një ndër to edhe pallati *-katësh, pasuri të cilat janë vënë në emër të familjarëve të tij.

83.1 Komisioni ka kryer hetim në kuptim të ligjit nr. 84/2016, lidhur me familjarët e subjektit duke u kufizuar, konkretisht, te shtetasit M dhe Xh.A për shkak se janë evidentuar në marrëdhënie huaje/dhurimi me subjektin e rivlerësimit. Lidhur me shtetasin Xh.A, Komisioni, në kuptim të hetimit ka administruar dhe vlerësuar dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti mbi ligjshmërinë e të ardhurave të këtij shtetasi.

83.2 Sipas informacionit të marrë nga Agjencia e Legalizimit Sarandë³¹ ka rezultuar se në emër të z. M.A figuron aplikimi për legalizimin e një ndërtimi pa leje me praktikën nr. sr-**** prot., datë 27.1.2015. Nga dokumentacioni bashkëlidhur rezulton se ndërtimi pa leje është një pallat **-katësh banimi, bashkë me ambiente për aktivitetet tregtare. Aplikimi është kryer nga z. Xh.A, si përfaqësues i z. M.A, mbi bazën e një prokure të përgjithshme me nr. ****, datë 2.10.2009 (aktfotokopje, i padukshëm mirë).

83.3 Nga administrimi i informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit Parave (DPPPP)³² evidentohen transaksione në vlera të konsiderueshme parash të kryera në “Bankën Kombëtare Tregtare” në llogaritë e shtetasit M.A (për periudhën 2010 – 2012), të kryera nga shtetasit M.A apo Xh.A (mbi bazën e prokurës me nr. *** kol., të dhënë nga M.A) me përfitues shtetasin M.A me burim, kryesisht, të ardhura nga aktiviteti, të ardhura personale, të ardhura nga emigracioni, pra, 24 depozitime *cash* në vlerën 26.237.500 lekë dhe 12 depozitime *cash* në vlerën 135.000 euro, në llogari të M.A.

83.4 Në informacionin e marrë nga DPPPP-ja, vihet re edhe një veprim i datës 31.1.2011 me përshkrimin dërgues: “M.A në vlerën 2.000.000 lekë *“sa kalon në favor të ‘E’ sh.p.k., likuidim situacioni”* me burim të ardhura.

83.5 Kjo shoqëri është referuar edhe në prokurën e përgjithshme me nr. *** kol., bashkëlidhur dokumenteve në dosjen e legalizimeve, ku shtetasi M.A i jep tagra shtetasit Xh.A për të realizuar marrëveshje me shoqërinë “E” sh.p.k. për blerjen e materialeve të ndërtimit të pallatit (kjo ishte njëkohësisht edhe shoqëria që ka punësuar bashkëshorten e tij).

83.6 Me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2019, Qendra Kombëtare e Biznesit informon se shtetasi M.A është i regjistruar si Person Fizik me NIPT L****J, datë 3.5.2010, me objekt investitor në fushën e ndërtimit me seli në Sarandë. Nga ekstrakti historik evidentohet vetëm një veprim i regjistruar pezullimi i aktivitetit në datën 13.5.2015.

83.7 Me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, për aktivitetin privat në vitet 2010 – 2015 është 0 (zero). Z. M.A nuk rezulton të ketë të ardhura të tjera, përveçse të ardhura nga pensioni, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

83.8 Komisioni, lidhur me shtetasin Xh.A, ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit të datës 3.7.2019. Komisioni i ka administruar shpjegimet dhe deklaratën e shtetasit grek dhe ka konstatuar se subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion shtetëror që të provojë deklarinimin si të ardhura të ligjshme nga punësimi në organin kompetent shtetëror grek. Nga verifikimet në sistemin *TIMS* nuk provohet që i vëllai të ketë udhëtuar drejt Greqisë deri në vitin 2018, për sa nuk ka gjurmë të këtyre udhëtimeve në këtë sistem.

83.9 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultatit, për sa personat e tjerë të lidhur, shtetasit M dhe Xh.A, nuk kanë pasur të ardhura të provuara me dokumentacion ligjor për të investuar mbi pasurinë, pallat **-katësh në qendër të Sarandës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

84.Subjekti shprehet: *“Lidhur me arsyetimin e dhënë nga ana juaj se personat e tjerë të lidhur, shtetasit M dhe Xh.A, nuk kanë pasur të ardhura të provuara me dokumentacion ligjor për të investuar mbi pasurinë, pallat *-katësh në qendër të Sarandës, parashatroj, si më poshtë:*

Së pari, me shtetasen B.S jam në armiqësi që nga viti 2003, fakt i ditur publikisht nga të gjithë. Për sa i përket arsyetimit tuaj se unë, shtetasi Petrit Aliaj, jam person i lidhur me babanë tim M.A dhe

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.3.2019.

³² Shkresë nr. *** prot datë 22.2.2019.

*vëllanë Xh.A për pallatin **-katësh që këta posedojnë, ky arsyetim nuk qëndron pasi unë jam person i lidhur me ta vetëm për marrëdhëniet e huas që unë kam me ta.*

Për sa i përket pasurive të tjera që ata posedojnë dhe disponojnë, unë nuk jam person i lidhur me ta, pasi unë jam shkëputur nga trangu familjar i babait dhe vëllait tim që në vitin 1986, fakt i provuar me certifikatë të trungut familjar datë 24.2.2020, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Delvinë dhe nuk kam asnjë lloj lidhje me pasuritë e tjera që ata posedojnë dhe disponojnë.”

85. Komisioni vlerësoi se duhet t'i trajtonte faktet e këtyre denoncimeve në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë, te subjektit të rivlerësimit. Komisioni gjendur përpara dyshimeve të ngritura nga denoncuesit të cilët kishin referuar për fshehje pasurie, vlerësoi të hetonte nëse babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit z.Petrit Aliaj ishte në gjendje të financonin këtë ndërtim.

85.1 Në përputhje edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit Komisioni ka tagrin që, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit hetimor të kryer në Komision.

85.2 Në rastin konkret, rezulton, që subjekti i rivlerësimit të ketë me vëllain dhe babain e tij marrëdhënie huaje. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kishte detyrimin të provonte burimin e ligjshëm të krijimit në lidhje me shumat e marra prej vëllait dhe babait të tij.

85.3 Por ky konkluzion, në të kundërt të sa pretendon subjekti, nuk kufizon Komisionin të bëjë hetimet e duhura për të verifikuar dyshimet e ngritura, në kuadër të verifikimit të fakteve bëra prezente nga denoncimet nga publiku të ardhura në Komision, sipas të cilave kjo janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.

85.4 Në këtë kuptim, pas hetimit të kryer në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në dokumentacionin e hetimit administrativ, rezultoi se vëllai dhe babai i subjektit, nuk kanë pasur burime të ligjshme për të financuar ndërtimin e pasurisë objekt denoncimi. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të pasurisë të personave të tjerë të lidhur me të.

85.5 Përveç këtij fakti, trupi gjykues nënvizon sa nga hetimi ka rezultuar se për pasurinë **banesë private e përbërë nga kati nëntokë dhe tri kate mbi tokë me sipërfaqe ndërtimi prej 105 m², e ndërtuar mbi tokën me sip. 200 m², në Sarandë**, marrëdhënia e subjektit dhe vëllait të tij, ishte disi e pazakontë, për sa vëllai pasi i jepte subjektit hua për blerjen e truallit, kontribonte personalisht në ndërtimin e kësaj banese dhe jepte vlerën monetare 15.000 USD, për 1/3 e pjesës takuese të tij për shlyerjen e detyrimeve monetare për ndërtimin e kësaj banese, i falte subjektit pjesën takuese në këtë banesë. Rrethana të tilla, në mënyrë indirekte, pa u konsideruar spekulative, informojnë trupin gjykues mbi marrëdhënien e subjektit me familjarët e tij.

85.6 Subjekti nuk provoi se kishte marrëdhënie armiqësie me shtetasin **K.M.N**, në ndryshim nga sa pretendoi për denoncuesen tjetër, për rrjedhojë trupi gjykues arrin në konkluzionin se deklaratimet e këtij denoncuesi, nuk mund të mos merreshin në konsideratë, gjatë procesit.

85.7 Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur ti provojë trupit gjykues se nuk gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84.2016, që lidhen me fshehjen e pasurisë, në funksion të shmangies së kontrollit nga organet e rivlerësimit të këtyre pasurive.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në referim të nenit D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.
- Bazuar në paragrafin 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cënimit të besimit të publikut të drejtësia, pasi ka përdorur funksionin e tij si magjistrat dhe ka shfrytëzuar dhënien e një vendimi gjyqësor për të bërë të mundur rregjistrimin e pasurisë së palës ndërgjyqëse, pjesë nga e cila posedonte edhe vetë, si dhe për qasjen e sjelljen e tij ndaj procesit të rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 58, pika 1/c, nenin 61, pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Aliaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.6.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja
Kryesuese

Xhensila Pine
Relatore

Brunilda Bekteshi
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka